

BIG DEAL

Të humbur në stagnim

Mbikëqyrja civile e zbatimit të marrëveshjes mes Kosovës e Serbisë

BigDeal!

“Cila ishte poenta e nënshkrimit të një marrëveshjeje për telekomin në shtator 2013, kur sot, në prill të vitit 2015, dikush si unë, gazetar, as që mund të përcjell informata për gazetën time nëse e kaloj kufirin me Serbinë, meqë telefonat kosovarë nuk mund ta përdorin roamingun në Serbi. Në Evropën e shekullit të njëzetentë, dy shtete evropiane nuk mund të flasim me njëri-tjetrin me telefona mobilë? Kam menduar që ky dialog do të na ndihmojë që të komunikojmë më mirë, por mendoj se e ka bërë pikërisht të kundërtën.”

—LAVDIM HAMIDI, GAZETAR I TË PËRDITSHMES KOSOVARE ZËRI

“Nuk jam e sigurt nëse ky proces i njohjes së diplomave ishte diçka serioze, apo ishte menduar vetëm ta tërheqë vëmendjen nga ky problem.”

—BESA ISMAJILI

“Ne kemi shumë më shumë probleme që nga fillimi i dialogut. Institucionet e Kosovës theksojnë se që nga muaji maj, do të jetë e pamundur të importohen ilaçe nga prodhues të Serbisë të cilët nuk regjistrohen në Kosovë. Nëse nuk e rregullojmë këtë të gjithë do të shkojmë në kolaps të plotë.”

—MILAN IVANOVIQ, DREJTOR, QENDRA KLINIKE NË MITROVICËN VERIORE

BIG DEAL

Të humbur në stagnim

Pas katër vjetësh nga fillimi i bisedimeve Kosova dhe Serbia po shënojnë progres në disa marrëveshje kyçe, gjersa të tjerat kanë ngecur.

Prill 2015
RAPORT #2

BigDeal!

“Që nga viti 2010 kam provuar të sigurohem që diploma ime nga fakulteti i mjekësisë në Beograd të njihet në Kosovë. Pa këtë, nuk kam të drejtë të punoj në klinika publike dhe kjo gjë më ka dëmtuar profesionalisht dhe personalisht. Unë jam vetëm një viktimë e lojërave politike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.”

— EDIS JONUZI, TERAPEUT FIZIK, PRIZREN

Nëse do të zbatohej marrëveshja e energjisë, qytetarët e Kosovës do të mund të përdornin energjinë e prodhuar nga hidrocentrali i Gazivodës në veri dhe të përdornin linjat e transmisionit të energjisë në Serbi për të siguruar energji për Kosovën – ku të dyja këto do ta bënin energjinë elektrike më të lirë për kosovarët mesatar.”

—DREN DOLI, GRUPI PËR STUDIME JURIDIKE DHE POLITIKE

Parathënie

Kanë kaluar katër vjet qëkur Kosova dhe Serbia filluan procesin e ndjeshëm të bisedimeve teknike dhe dy vjet qëkur u nënshkrua marrëveshja historike për “normalizimin” e marrëdhënieve. Megjithatë, gjendja në terren për sa i përket marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe veçanërisht në katër komunitat veriore të Kosovës, është larg nga të qenët normale. Ndonëse ka arsye për të shpresuar, ka edhe arsye për frustrim të vërtetë.

Para gjashtë muajsh BIG DEAL publikoi raportin e parë me titull “Monotoni e qytetëruar?”. Titulli aludon në storien e shkurtër të humoristit britanik Saki, i cili ishte gazetar gjatë luftërave të Ballkanit të fillimit të viteve ‘900. Ai shkroi

për luftërat e ashpra e shkatërruese të Ballkanit dhe për diplomatët perëndimorë që formësuan ngjarjet pasuese për të mirë a për të keq.

Saki, emri i vërtetë i të cilit ishte H.H. Munro, shprehu besimin e tij se pas një kohe nuk do të ketë më territore të kontestuara në Evropën Juglindore dhe se ky kënd i vogël i Ballkanit përfundimisht do të jetë po aq banal sa edhe pjesa tjetër e Evropës... apo me një frazë, “monotoni e qytetëruar”.

Njëqind vjet pas historisë së Sakit, Kosova e Serbia të nxitura nga Bashkimi Evropian, janë angazhuar në procesin e normalizimit me këtë qëllim në mend.

Këto ditë monotonia lidhet me faktin se pak nga ndryshimet e premtuara me marrëveshjet e deritashme janë realizuar.

“Nëse ka vullnet të mirë politik, ka edhe zgjidhje kreative. Serbia ka bërë gjëra që janë në kundërshtim me kushtetutën e saj dhe tani Prishtina ankohet se serbët janë duke e shkelur ligjin e saj për vetëqeverisje lokale?”

—ZYRTAR KOMUNAL, KOSOVË VERIORE

Mirënjohje

BIRN-i në Kosovë dhe Internews Kosova janë bashkuar me Qendrën për Hulumtim, Transparencë dhe Llogaridhënie – CRTA, në Beograd për të monitoruar zbatimin e marrëveshjeve ndërmjet të dy vendeve, me ndërmjetësim të Bashkimit Evropian që nga viti 2011.

Ky raport është pjesë e një projekti më të madh, BIG DEAL: Mbikëqyrja civile e zbatimit të marrëveshjes mes Kosovës e Serbisë. Raporti është mundësuar përmes mbështetjes nga Zyra Britanike për Punë të Jashtme si dhe Fondi Rockefeller Brothers.

Raporti është hulumtuar nga Vukosava Crnjanski, Rasa Nedeljkov, Zyra Britanike për Punë të Jashtme nga CRTA dhe Jeta Xharra, Faik Ispahiu e Paulina Nushi nga BIRN Kosova dhe Internews Kosova si dhe Una Hajdari dhe Zana Cimili. Raporti është hartuar nga Valerie Hopkins dhe redaktuar nga Nate Tabak.

Ky është “raporti i dytë i progresit” nga një sërë raportesh me fokus në zbatimin e marrëveshjeve mes Kosovës e Serbisë. Hulumtimi mbështetet në intervista me më shumë se 100 burime nga vendimmarrës të lartë qeveritarë deri te qytetarët e thjeshtë që përballen me ndryshimet në jetën e tyre. Burimet përfshijnë zyrtarë nga Qeveria e Kosovës dhe ajo e Serbisë, përfaqësues të Bashkimit Evropian, si dhe burime primare dhe sekondare.

CRTA ka ndërtuar reputacionin dhe kredibilitetin e saj në opinionin publik serb si mbikëqyrëse e qeverisë dhe avokuese e vendimmarrjes transparente dhe të përgjegjshme. CRTA fuqizon qytetarët me informata dhe mobilizon publikun për të reaguuar atëherë kur zyrtarët dhe institucionet publike nuk respektojnë obligimin e tyre të transparencës. Përmes promovimit të llogaridhënies si vlerë themelore të demokracisë, CRTA ushtron ndikim mbi zyrtarët publikë për të përmirësuar llogaridhënien e tyre ndaj qytetarëve, hapur dyert e veprimtarisë së Kuvendit të Serbisë dhe institucioneve të tjera, si dhe për të shtuar transparencën e buxheteve lokale.

BIRN Kosovo dhe Internews Kosova bashkëpunojnë në prodhimin e debeteve televizive dhe programeve hulumtuese më të shikuara dhe vlerësuara në Kosovë. Në shtator 2012, Internews Kosova dhe BIRN Kosovo lansuan një platformë të re televizive - “Temën”. Në episodin e parë të programit u mbledhën së bashku palët e interesit nga të dy vendet në një debat të paparë më herët për të diskutuar për shqetësimet e qytetarëve në lidhje me standardet e jetesës dhe progresin, rëndësinë dhe interpretimin e disa marrëveshjeve të arritura deri në atë kohë. Dhjetë debate që mbulonin çështje duke filluar nga Liria e lëvizjes deri te bashkëpunimi kulturor janë transmetuar si në Kosovë ashtu dhe në Serbi në kanalet kryesore televizive.

Përmbajtja

Parathënie	5
Mirënjohje	6
Përmbajtja	7
Përmbledhje ekzekutive	8
Hyrje	14
Marrëveshjet	17
Liria e lëvizjes dhe mallrave	23
Dogana dhe tregtia e lirë	26
Ndryshimet që ndikojnë te serbët e Kosovës, veçanërisht në komunat veriore	30
Strukturat paralele	31
Asociacioni i Komunave	32
Siguria	35
Mbrojtja Civile	36
Gjyqësori	38
Dokumentet: Diploma, regjistri civil, kadastra	40
Kosova dhe botë	44
Telekomi	46
Energjia	48
Konkluzë	50

Përmbledhje ekzekutive

Në fillim të vitit 2015 kanë ndodhur disa gjëra të cilat do të dukeshin të paimagjinueshme madje vetëm pak muaj më parë: Ministri i Jashtëm i Serbisë, Ivica Dačić vizitoi Prishtinën dhe piu kafe me homologun e tij të Kosovës, Hashim Thaçin.¹

Në mars, kryeministri i Kosovës Isa Mustafa bëri të ditur se kanë pasur komunikim të drejtpërdrejtë me telefon me njëri-tjetrin.²

Ky njoftim u përgëzua në Bruksel.

“Vetëm fakti që ka kontakt, pa lehtësimin e Brukselit, është rezultat i madh”, tha Përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Evropian për Politikë të Përbashkët dhe Sigurisë (HRVP), Federica Mogherini. Veçanërisht, “krahasuar me situatën e disa viteve më parë”.

“Objektivi im personal do të ishte që lehtësimi i Brukselit të mos jetë më fare i nevojshëm fare”, shtoi ajo.

Qe katër vite tashmë, Brukseli është duke e lehtësuar dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Së pari nën mbikëqyrjen e paraardhëses së Mogherinit, Baroneshës Catherine Ashton, ai kishte formën e dialogut teknik. Dy vite më vonë, filloi dialogu në nivel të kryeministrave, dhe më 19 prill 2013, Kosova dhe Serbia, me lehtësimin e Bashkimit Evropian, nënshkruan “marrëveshjen e parë për parimet që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve”. Marrëveshjet, të lidhura pas vitesh zemërimi dhe raportesh të ftohura, premtinin që përfundimisht ta zgjidhnin çështjen e katër komunave veriore të Kosovës dhe t'i mundësonin Beogradit që të zbehë në masë të madhe ndikimin e tij financiar dhe politik në Kosovë.

Saktësisht dy vite më vonë, pjesa më e madhe e progresit të paraparë vazhdon të mos realizohet, dhe e ardhmja pa angazhim të thellë të BE-së duket si një ëndërr e largët.

Shumica e premtimeve të marrëveshjes së 19 prillit të vitit 2013, vazhdojnë të mos realizohen, si dhe nuk janë iniciuar tema të reja. Në gjashtë muajt pas raportit të parë BIG DEAL, është shënuar progres i vogël në zbatimin e marrëveshjeve dhe një varg ngjarjesh që kulmuan me disa protesta masive dhe shkarkimin e një serbi të Kosovës tregojnë sa i brishtë ishte progresi.

Gjashtë muaj pas ngërçit politik, Kosova formoi qeverinë në dhjetor të vitit 2014, por koalicioni i dy partive më të mëdha shqiptare, Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe partisë serbe të Kosovës, Lista Srpska, pothuajse menjëherë u tensionua. Pas shkarkimit të liderit të saj Aleksandar Jablanović, i cili ishte Ministër për Komunitete dhe Kthim, Lista Srpska u tërhoq nga qeveria në fillim të shkurtit 2015. Udhëheqësit e partisë kërkuan konsultime me Beogradin³ dhe nuk janë lëkundur

¹ “Nuk mund të flasim për paqen ata që nuk dinë çka është lufta,” Ivica Dacic, Nedeljnik, 2 prill 2015.

² “Kryeministri i Kosovës thotë se ka linjë të drejtpërdrejtë me Beogradin,” Una Hajdari, BalkanInsight, 26 mars 2015. <http://www.balkaninsight.com/en/article/kosovo-pm-we-have-established-a-direct-line-to-belgrade>

³ “A do të mbetet Lista Srpska në Qeveri? Këshillat vijnë nga Beogradi,” N1, 2 shkurt 2015. <http://rs.n1info.com/a32747/Vesti/Srpska-lista-odlucuje-o-ostanku-u-Vladi-Kosova.html>

nga qëndrimi i tyre për të mos marrë pjesë në jetën publike të Kosovës deri kur të jenë përbushur kërkesat e tyre. Kushti kryesor është krijimi i Asociacionit/Bashkësisë së Komunave me shumicë serbe, brenda afatit të parashikuar në marrëveshjen e koalicionit, me një afat pesëmuor që skadon më 12 Maj.⁴

Përfaqësuesja e Lartë e BE-së (HRVP), Federica Mogherini, u emërua në nëntor të vitit 2014. Duke pasur parasysh konfliktin në Ukrainë dhe krizën në Greqi, në mesin e prioriteteve të tjera të politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë, Mogherini nuk i thirri kryeministrat për dialog të nivelit të lartë deri në shkurt 2015, ndërsa vizitën e saj të parë në Kosovë dhe në Serbi e realizoi vetëm në fund të marsit 2015.

Megjithatë, të dyja këto ngjarje rezultuan me progres: më 10 shkurt, pas negociatave disaorëshe, të dy palët nënshkruan një marrëveshje që premtonte të sillte një sistem gjyqësor në tërë Kosovën, pas 16 vjetësh. Marrëveshja përvijonte zotimin e të dyja palëve në Marrëveshjen e Brukselit për një gjyqësor të unifikuar si dhe përfshinte një plan për realizimin e saj. Vendet e reja të punës për gjykatat e ardhshme janë shpallur në mars dhe aplikacionet janë duke u pranuar.

Gjatë vizitës së saj në Kosovë në mars, Mogherini njoftoi se të dyja palët kishin arritur një marrëveshje për shpërbërjen e Mbrojtjes Civile, e cila për një kohë të gjatë nga Prishtina shihej si kërcënim ndaj sigurisë, por që nga serbët e veriut të Kosovës shihet si punëdhënëse dhe shërbim jetik për qytetarët. Serbia duhet t'i shpërbëjë këto njësi menjëherë, si dhe t'i inkurajojë pjesëtarët e saj që të zënë pozita përkatëse në sistemin e Kosovës.

Nga 16 marrëveshjet, vetëm katër janë zbatuar në tërësi. Vulat doganore, këmbimi i regjistrave civilë, zgjedhjet komunale në veri të Kosovës dhe krijimi i një komisioni të zbatimit. Kjo gjendje nuk ka ndryshuar në gjashtë muaj.

Ende nuk është dorëzuar projekt-statuti i Asociacionit/Bashkësisë së Komunave me Shumicë Serbe, i cili do të jetë çelësi për zhbllokimin dhe integrimin e plotë të serbëve në institucionet e Kosovës. Kështu, serbët e Kosovës vazhdojnë të jenë të varur në kujdesin shëndetësor dhe arsimin e ofruar drejtpërdrejtë nga Serbia, sisteme të cilat i parapëlqejnë dhe në të cilat duhet të vazhdojnë të kenë qasje. Mijëra serbë gjithashtu ende mbështeten tek Serbia për punësimin e tyre. Me kujdes por dhe me shpejtësi, duhet të bëhen aranzhime për punësimin e tyre nën sistemin e Kosovës, gjë që do të lehtësonte integrimin dhe do të ulte shqetësimet lidhur me mundësinë e jetesës së ardhshme.⁵

Statuti i Asociacionit /Bashkësisë tani përfaqëson një të ardhme të qëndrueshme për serbët në Kosovë. Kuadri ligjor ekzistues në Kosovë siguron hapësirë për të drejta substanciale dhe vetëqeverisje, por nuk duhet të shihet si

⁴ “Kushti i Listës Srpska për kthim është respektimi i marrëveshjes,” N1, 3 prill 2015. <http://rs.n1info.com/a48706/Vesti/Uslov-Srpske-liste-za-povratak-jeste-postovanje-sporazuma.html>

⁵ Duhet të theksohet se numri i njerëzve të punësuar në institucionet serbe tejkalon nivelet proporcionale të punësimit në institucionet e Kosovës në krahasim me banorët e tyre. Kjo do të thotë se “integrimi” i punëtorëve serbë në institucionet e Kosovës do të rezultojë në institucione të fryra për një kohë. Ky proces duhet të kryhet së bashku me auditimin e rekomanduar të të punësuarve në strukturat serbe.

instrument për më shumë pushtet. Nuk duhet të shihet si mënyrë për ta penguar integrimin, apo si zëvendësim për lidhjet me Prishtinën.

Çështje të tjera si Telekomit dhe Energjia janë shumë prapa datës së tyre të paraparë për zbatim. Ndonëse zyrtarë të të dyja qeverive dhe Bashkimit Evropian⁶ thonë se janë në prag të realizimit, kjo ende nuk ka rezultuar në ndryshime të dobishme për qytetarët. Për shembull, ndonëse marrëveshja e telekomit u nënshkrua në shtator të vitit 2013, palët nuk janë pajtuar edhe për plan të përbashkët të zbatimit⁷. Për sa i përket energjisë, ndonëse është nënshkruar plani i zbatimit⁸, analiza jonë tregon se 7 nga 10 hapat e rënë dakord në plan nuk janë plotësuar në afatin për të cilin janë pajtuar të dyja delegacionet.

Megjithatë, çështje të tjera që dukeshin si të përfunduara, siç janë përfshirja e punonjësve serbë të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MUP) në Policinë e Kosovës, janë rishfaqur, meqë punonjësit e papërfshirë administrativë kanë protestuar në kohën e publikimit për shkak se nuk janë bërë aranzhime për inkorporimin e punonjësve të MUP-it që jetojnë në jug të lumit Ibër, apo të stafit administrativ në veri, duke i lënë jashtë perspektivës së punësimit rreth 800 njerëz⁹.

Kosova është e palëkundur në atë që krijimi i Asociacionit do të bëhet vetëm pasi të jenë zbatuar marrëveshjet për drejtësi dhe siguri dhe pasi të jetë larguar barrikada në urën e lumit Ibër, si dhe pasi të jenë shpërbërë të gjitha të ashtuquajturat institucione “paralele” të Serbisë.

Transparenca vazhdon të mbetet çështje shqetësuese. Marrëveshja për drejtësi nuk është diskutuar nga Kuvendi i Kosovës dhe madje teksti i saj nuk është pranuar nga parlamentarët, deri një muaj pas nënshkrimit. Në Serbi, parlamentarët madje nuk kanë arritur as të sigurojnë kopje të marrëveshjeve.

Kanë mbetur pak matës objektivë për progresin. Ambasadorja gjermane në Kosovë, Angelika Viets, kohëve të fundit kërkoi që të lëshohet një dokument i monitorimit, i ngjashëm me raportet e progresit vjetor të Komisionit Evropian për vendet aspirante.¹⁰

Megjithatë, ka arsye për optimizëm: lajmi që kryeministrat Isa Mustafa dhe Aleksandar Vuçiq tani flasin drejtpërsëdrejti përmes telefonit jep pak shpresë. Samiti i liderëve të Ballkanit Perëndimor në Prishtinë në fund të majit tregoi për bashkëpunimin pozitiv. Është gjithashtu mirë që të dy rastet ku Mogherini u angazhua drejtpërdrejt rezultuan me marrëveshje, ndonëse burime të njohura me procesin e dialogut theksojnë se këto marrëveshje pak a shumë janë arritur para largimit të paraardhëses së Mogherinit, Baroneshës Catherine Ashton.

Perspektiva e një sistemi të unifikuar të drejtësisë për Kosovën pas 16

6 Intervista me zyrtarë të qeverisë së Kosovës dhe Serbisë, si dhe përfaqësues të ambasadave të BE-së gjatë kohës së periudhës së raportimit.

7 Intervistë me Drejtorin e Rregullatorit të Telekomit ARKEP, Ekrem Hoxha, prill 2015.

8 http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/141111_Road_Map_for_implementation_of_action_Plan_Energy_ZrE_KEDS_KOSTT.pdf

9 “Punëtorët e paintegruar të MUP-it nga Mitrovica: nuk kemi pranuar përgjigje në kërkesa, nesër konferenca për shtyp para zyrave tona të mbyllura,” KosSev, 2 mars 2015. http://kossev.info/sfrana/arkhiva/neintegrisani_radnici_mup_a_iz_kosovske_mitrovice__na_zahteve_nismo_dobili_odgovor_sutra_konferencija_zamedije/4013

10 Deklarata për 21 janarin 2015.

vjetësh është shumë e mirë, ndonëse sistemi hibrid i Kosovës, me një prani të madhe të Misionit të BE-së të Sundimit të Ligjit (EULEX) dhe Dhomave të Posaçme që do të formohen së shpejti për hetimin e pretendimeve në raportin e Këshillit të Evropës të vitit 2010 japin përshtypjen e një sistemi gjyqësor të arnuar, të improvizuar dhe të paintegruar. Për më tepër marrëveshja për drejtësinë në veri të Kosovës është e bazuar në diskriminim etnik: vendet e punës janë paraparë vetëm për serbët dhe shqiptarët, por edhe për pakicat e tjera siç janë boshnjakët, RAE, e të tjerë.

BIG DEAL nuk përkrahë medoemos çdo marrëveshje të arritur mes Serbisë dhe Kosovës. Megjithatë, procesi duhet të monitorohet dhe raportohet në baza të rregullta për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie të procesit të dialogut dhe institucioneve të Kosovës dhe të Serbisë, si dhe Bashkimit Evropian si lehtësues dhe garantues të zbatimit.

Rekomandime

Për Kosovën, Serbinë dhe bashkësinë ndërkombëtare, veçanërisht BE-në:

- Informimi dhe transparenca janë shqetësim madhor për publikun. Lënia e rolit të komunikimit të informatave në lidhje me marrëveshjet për “normalizim” të muajit prill 2013 te qeveritë e Kosovës dhe Serbisë ishte vendim me pasoja negative që nga fillimi. Zyrtarë të qeverive e Kosovës dhe Serbisë shpeshherë i diskutojnë marrëveshjet në mënyrë populliste dhe jo si burrështetas. Kjo gjë ka dëmton rëndë procesin dhe duhet të miratohet një strategji e re e komunikimit. Të dyja palët kanë narrativat dhe interpretimet e tyre të marrëveshjeve dhe publiku është mashtruar për të besuar që të dyja palët kanë qenë fitimtare ndaj tjetrës. Kjo vlen veçanërisht në lidhje me Asociacionin / Bashkësinë e komunave me shumicë serbe, njohjen e diplomave dhe targat e makinave. Informimi i gabuar dhe dykuptimësia për atë që është duke u vendosur krijon ose zmadhon zbrazëtitat midis komuniteteve dhe rritë mosbesimin mes njerëzve dhe institucioneve në të dyja anët. BE-ja duhet të marrë parasysht krijimin e një portali informativ të dialogut, siç duhet të veprojnë edhe të dyja qeveritë.
- Të gjendet një zgjidhje urgjente për problemin e njohjes reciproke të diplomave që do t’u mundësojë të gjithë qytetarëve të kenë qasje të barabartë në mundësi të punësimit. Institucionet e Kosovës duhet ta trajtojnë çështjen e arsimit cilësor për serbët dhe Beogradi duhet ta gjejë vullnetin politik për t’i lejuar serbët e Kosovës që të integrohen tërësisht në sistemin arsimor të Kosovës.
- Të inkurajohet transparenca në procesin e themelimit të Asociacionit / Bashkësisë së Komunave me Shumicë Serbe dhe të sigurohet që komunitetet lokale janë të përfshira në të. Duhet që menjëherë të lëshohet për konsultim të përgjithshëm një projekt-statut. Miratimi i statutit

duhet të ndodhë vetëm pas konsultimeve të gjera me grupet e shoqërisë civile

- Të mos lejohet që negociatat për statutin e Asociacionit /Bashkësisë të vonojnë integrimin e serbëve të Kosovës në të gjitha nivelet e qeverisë së Kosovës. Të zhvillohet dhe publikohet një plan kohor me afate përkatëse.
- Të krijohet një trup i përbërë nga aktorë të shoqërisë civile që do të angazhohen në procesin e zbatimit dhe për të dhënë sqarime dhe shpjegime të marrëveshjeve për publikun.
- Ballafaqimi me të kaluarën të bëhet pjesë e dialogut duke siguruar zotime nga të dyja palët për t'i shpalosur arkivat e tyre dhe të mbështetet mandati i KOMRA-s. Të themelohet një grup i pavarur ekspertësh për t'i rishikuar tekstet shkollore të historisë.

Për qeverinë e Kosovës dhe Serbisë

- Siç është propozuar nga një dokument politik i lëshuar kohëve të fundit mbi integrimin e serbëve në Kosovë, agjencitë përkatëse të të dy qeverive duhet të kryejnë një "analizë gjithëpërfshirëse në terren lidhur me punësimin në institucionet e financuara nga Serbia dhe komunat me shumicë serbe."¹¹ Kjo duhet të përdoret si bazë të punësorë punonjës në sistemin e Kosovës dhe për të dërguar gradualisht personat e tepërt në pension të parakohshëm.
- Të dyja qeveritë duhet të bëjnë çmos që t'i inkurajojnë kompanitë e sigurimeve që t'i largojnë tarifatat e larta të sigurimit për automjete që bëjnë që udhëtimi nga Kosova në Serbi dhe anasjelltas të jetë jashtëzakonisht i shtrenjtë¹².
- Serbia duhet t'i inkurajojë serbët e Kosovës që të kërkojnë punësim në institucionet e Kosovës, veçanërisht jashtë ministrive në të cilat tradicionalisht punojnë (Ministria për Komunitete dhe Kthim, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale), dhe të marrin pjesë në të gjithë spektri i agjencive.

Për Kosovën

- Qeveria e Kosovës duhet të inkurajohet që të hartojë dhe zbatojë një

¹¹ Grupi Hulumtues i Politikave të Ballkanit, "Integrimi i serbëve në Kosovë pas marrëveshjes së Brukselit." Mars 2015.

¹² Hulumtimi për këtë raport ka treguar se edhe qeveria serbe edhe ajo kosovare mund të ndikojnë tek kompanitë e sigurimit të cilat pretendojnë të jenë të "pavarura" në përcaktimin e tarifave të sigurimit. Dunav Osiguranje, një nga kompanitë kryesore të sigurimeve në Serbi është në pronësi publike dhe besohet të jetë e drejtuar nga miq të politikës. Sipas Këshillit Fiskal të Qeverisë së Serbisë viteve e fundit ka vepruar në humbje (http://www.fiskalnisavet.rs/doc/eng/analysis_of_state-owned_enterprises-fiscal_aspect.pdf) dhe është duke i mbuluar këto humbje dhe mbi 3000 të punësuar përmes, ndër të tjera, këtyre tarifave të larta të sigurimit që mblidhen në kufi. Në anën e Kosovës, Gani Thaçi, vëllai i ish-kryeministrit Thaçi, është zëvendëskryetar i Byrosë së Sigurimit të Kosovës që mbikëqyr dhe rregullon të gjitha kompanitë e sigurimit. Rrahim Pacolli, vëllai i një tjetër politikani të Kosovës, Behgjet Pacolli, i cili drejton një kompani private të sigurimit, u emërua në krye të delegacionit teknik të Kosovës për të negociuar me delegacionin serb në lidhje me kartonat e gjelbër dhe tarifatat e sigurimit (shih: <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,9,4280>). Këto marrëdhënie që klasa politike i ka me kompanitë e sigurimeve janë kritikuar për atë që njerëzit që nxjerrin fitime financiare nga mbajtja e tarifave të larta të sigurimit të makinave nuk mund të jenë ata që do të priten të negociojnë një lëvizje të "lirë"

strategji të re të komunikimit në terren për komunat veriore. Kjo do t'u japë më shumë kredibilitet deklaratave të saj të mbështetjes së gjithëpërfshirjes për të gjithë qytetarët e Kosovës.

- Të merren të gjitha përpjekjet e nevojshme për të përcaktuar se sa serbë jetojnë në Kosovë dhe ku dhe kjo të përdoret si bazë për buxhetet, projektet dhe aktivitetet e ardhshme.
- Të përforcohet Zyra për Çështje të Komuniteteve në kuadër të kabinetit të kryeministrit. Zyra duhet të angazhohet që të përcjellë nga afër nivelet e punësimit të serbëve dhe pakicave joserbe në institucionet e Kosovës.
- Të ofrohen kurse të gjuhës shqipe dhe serbe për të gjithë punonjësit e qeverisë dhe të krijohen stimulime për ta mësuar cilëndo gjuhë joamtare.
- Gjithashtu, Kuvendi duhet ta miratojë Ligjin për Themelimin e Agjencisë Kosovare të Krahimit dhe Verifikimit të Pronës (AKKVP).
- Organet e zbatimit të ligjit të Kosovës duhet të kërkojnë marrëdhënie formale me Interpolin dhe Europolin dhe të dorëzojnë aplikacion të plotë dhe të detajuar për anëtarësim në Interpol dhe të kërkojnë që Këshilli i Ministrave të BE-së ta përfshijë Kosovën në listën e shteteve të treta dhe organizatave të jashtme me të cilat Europol duhet të kërkojë marrëveshje strategjike dhe operacionale, me qëllim të bashkëpunimit ndërkombëtar policor për sigurinë e Evropës dhe ta vendosë Kosovën në pozitë të barabartë me vendet e tjera kandidate dhe kandidate potenciale.

Për Serbinë

- Të publikohen raporte të rregullta në lidhje me nivelin e zbatimit të marrëveshjeve. Kuvendi i Serbisë duhet ta ratifikojë marrëveshjen e Brukselit.
- Të harmonizohet me shpejtësi legjislacioni për të qenë në përputhje me marrëveshjen e 19 prillit dhe marrëveshjet teknike.
- Të diskutohet "Anketni Odbor"¹³ në Parlament dhe bëhet transparent i tërë financimi për Kosovën.
- Të inkurajohet një kulture politike organike, me fokus në udhëheqje lokale për përfaqësimin e komunitetit serb të Kosovës. Të inkurajohen udhëheqësit e serbëve të Kosovës që të marrin pjesë në institucionet jo vetëm që janë të lidhura me komunitetet apo pakicat, por që janë të rëndësishme për të gjithë qytetarët.
- Ngadalë të largohet "privremeno vijece", apo këshillat e përkohshëm, duke siguruar mjete të jetesës për njerëzit e punësuar në to. Të inku-

¹³Anketni Odbor ishte një hulumtim i një komisioni anketues të themeluar nga parlamenti serb për të përcaktuar se sa shpenzon Serbia në Kosovë. Ai gjeti se kostot janë deri në 860.000 euro në ditë, por një pjesë e madhe e këtyre mjeteve nuk mund të arsyetoheshin. Raporti është në dispozicion që më shumë se një vit, por ende nuk është diskutuar publikisht nga parlamenti.

rajohen ata që do ta vazhdojnë punësimin në sistemin e Serbisë që të transferohen në sistemin kosovar, duke i siguruar se do t'i ruajnë të drejtat e tyre në pensione të Serbisë, duke përfshirë edhe për vitet që kanë punuar në sistem të Kosovës.

- Të mbyllet sistemi paralel i gjykatave dhe organizatat paralele të sigurisë, duke përfshirë njësitë e Trupave të Mbrojtjes Civile.
- Për komunitetin ndërkombëtar, veçanërisht Bashkimin Evropian duhet ta konsiderojë krijimin e portalit informativ të lidhur me dialogun, gjë që duhet të bëjnë edhe të dyja qeveritë.
- BE-ja duhet të konsiderojë publikimin e “raporteve të rregullta të progresit” mbi gjendjen e zbatimit të marrëveshjeve dhe të vërë afate kohore për zbatimin e tyre duke i shfrytëzuar këto afate si presion ndaj të dyja palëve në mënyrë që të mos zvarritet pafundësisht procesi.
- BE-ja duhet të kërkojë transparencë më të madhe nga personat negociues në të dy ekipet dhe të kërkojnë përfshirje më të madhe në përbërjen e këtyre ekipeve.
- BE-ja duhet të vazhdojë ta mbështesë dhe inkurajojë zhvillimin e mëtejshëm ekonomik dhe t'i realizojë zotimet e saj për financim.
- Duke pasur parasysh mbylljen potenciale të misionit të EULEX-it në qershor të vitit 2016 dhe statusin e Kosovës si vend kandidat potencial për anëtarësim në BE, Këshilli i Bashkimit Evropian duhet ta propozojë Kosovën si vend kandidat për anëtarësim në Europol.
- Në disa raste ndihma e aktorëve jo të BE-së ishte vendimtare në thyerjen e bllokadave. Këta aktorë duhet ta vazhdojnë angazhimin e tyre, ose në disa raste, të riangazhohen në procesin e zbatimit të marrëveshjeve.

Hyrje

Marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë ishin armiqësore në vitet pas luftës 1998-1999 dhe u përkeqësuan edhe më tej pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës më 2008. Takimet politike të nivelit të lartë në fakt nuk ekzistonin fare deri më 2011, kur me thirrje të Bashkimit Evropian negociatorët e të dyja palëve u takuan për t'i arritur disa marrëveshje politikisht jopopullore që premtinin të përmirësojnë përfundimisht jetesën e qytetarëve të tyre.

Katër vjet pas fillimit të dialogut Kosovë-Serbi, të dyja palët janë tani në prag të krijimit të kushteve për integrim të vërtetë të serbëve në Kosovë. Me shpresën se katër komunitatet veriore do të sillen nën kontrollin e Kosovës për herë të parë, Beogradi dhe Prishtina, me këshilla të komunitetit ndërkombëtar, krijuan një elitë të re politike, të lidhur më shumë me Beogradin sesa Prishtinën. Në shumë mënyra, Prishtina duhet të varet nga Beogradi për ta nxitur pjesëmarrjen e tyre në qeveri. Është real rreziku që pakica serbe e Kosovës do të instrumentalizohet për përfitime edhe të Prishtinës edhe të Beogradit, por jo medoemos të komuniteteve të tyre lokale.

Zbatimi i marrëveshjeve të arritura që nga viti 2011 ishte jo i plotë dhe kishte ngecur në vitin e fundit, pasi që zgjedhjet në Serbi, Parlament Evropian dhe

Kosovë vonuan ndryshimin në praktikë.

Ekipet teknike punuan gjatë gjashtë muajve të bllokimit politik në Kosovë, por asnjë marrëveshje politike e nivelit të lartë nuk u arrit.

Në dhjetor të vitit 2014, Kosova formoi një qeveri të përbërë nga dy partitë e saj më të mëdha, LDK dhe PDK, si dhe Lista Srpska, parti e Kosovës e themeluar para zgjedhjeve të nëntorit 2013 në Kosovë, të parat zgjedhje të Kosovës ku morën pjesë të katër komunitatet veriore me shumicë serbe. Partia ka pranuar mbështetje financiare dhe politike nga Beogradi. Në janar koalicioni hasi në vështirësi, përkujtues ky emocional i nevojës së vazhdueshme për dialog të qëndrueshëm dhe angazhim rigoroz të BE-së.

Deklaratat kontroverze të udhëheqësit të Listës Srpska, Aleksandar Jablanović, i cili i quajti anëtarët e një organizate të viktimave të luftës në Kosovë si “egërsira” pasi penguan pelegrinët ortodoksë serbë në afërsi të Gjakovës, nxitën një sërë protestash, duke përfshirë dy në Prishtinë, të cilat tërhoqën dhjetëra mijëra protestues¹⁴. Një nga shkaqet kryesore ishte zemërimi ndaj ministrit Jablanović, i cili u bë sinonim për atë që perceptohej si rritje e nivelit të përfshirjes së Beogradit në politikën e Kosovës, rezultat i drejtpërdrejtë i dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja. Kërkimfalja e dështuar e Jablanovićit, gjatë së cilës ai tha se nuk “ishte në dijeni” nëse forcat serbe të sigurisë kishin kryer krime lufte në Kosovë, ngriti edhe më tej tensionet.

Në të njëjtën kohë, kryeministri Mustafa njoftoi se miniera e Trepçës, që për shumë kosovarë është simbol i shpresës ekonomike të vendit, do të nacionalizohet në prag të kalimit të afatit tek Agjencia Kosovare e Privatizimit. Beogradi është ankuar se nuk ishte konsultuar asnjëherë dhe kabineti i Mustafës gjeti një mënyrë për ta zgjatur procesin për 36 muaj.

Liderët serbë të Kosovës, që ankoheshin se Prishtina nuk kishte informuar për vendimet kyçe duke përfshirë largimin e Jablanovićit dhe nacionalizimin e Trepçës, i qëndruan pranë Beogradit.¹⁵

Frustrimi u rrit më tej me perceptimin se Mustafa po tërhoqte karshi presionit nga Beogradi, si dhe nga fakti se për dy javë ai nuk pranoi kërkesën e protestuesve që ta shkarkojë Jablanovićin.

Në të njëjtën kohë, kosovarët largoheshin në turma, përmes kufirit të Serbisë me Hungarinë në shpresë të azilit në Evropën Perëndimore. Pas protestave, numri i azilkërkuarve kulmoi në atë që u nxiti traumë kombëtare. Kjo ishte një mundësi e humbur për bashkëpunim policor ndërmjet Serbisë dhe Kosovës dhe u manipulua në mediat masive serbe për ta paraqitur Kosovën në një pasqyrë negative. Megjithatë BIRN-i gjeti prova se bandat kriminale serbe e shqiptare bashkëpunonin në sigurimin e një terreni të favorshëm për biznesin e kontrabandës së njerëzve që arriti t'i dërgojë rreth 70.000 njerëz nga Kosova përmes Serbisë për në Hungari dhe në Evropën Perëndimore brenda tre deri në

¹⁴ Shih “Vala e zemërimit shtyn protestuesit në cep,” Balkan Insight, 30 janar an 2015. <http://www.balkaninsight.com/en/article/wave-of-fury-pushes-kosovo-to-the-edge>

¹⁵ Intervistë me një diplomat perëndimor në Beograd, mars 2015.

katër muaj.¹⁶

Ministri i Kosovës për Diasporë, Valon Murati ngriti edhe më tej tensionet përmes komentit të tij se eksodi ishte rezultat i “pozitave të privileguara të pakicave”.¹⁷

Pothuajse të gjithë serbët që shërbejnë në Qeverinë e Kosovës si pjesë e “Listës Srpska” u tërhoqën nga parlamenti dhe ministrinë e tyre, duke bërë i thirrje publike Beogradit për t’i këshilluar nëse do të mbesin në qeveri apo jo, gjë që shkaktoi pakënaqësi në Prishtinë.

Ndërkohë, Serbia vazhdoi të paguajë më shumë se 5,100 punonjës që shërbejnë në pozita në Kosovë përmes organeve të quajtura privremeno vijece, apo këshilla të përkohshëm.

Shumica e strukturave serbe ende ekzistojnë, veçanërisht në veri të Kosovës. Shumë nga ata që u zgjedhën në zgjedhjet e Kosovës në nëntor 2013 tani kanë pozita edhe në sistemin e Kosovës edhe në atë të Serbisë. Nga tetori deri në dhjetor të vitit 2014, qeveria serbe emëroi punonjës shtesë në qendrën mjekësore në Pejë dhe Dragash, në Teatrin Kombëtar në Prishtinë me seli të përkohshme në Graçanicë dhe në struktura të shumta komunale.

Spitalet dhe shkollat vazhdojnë të financohen përmes sistemit serb, pasi që nuk ka ekuivalente institucionale të Kosovës në katër komunat veriore. Shumica e serbëve që jetojnë atje duan vazhdimësi të këtyre institucioneve meqë kanë më shumë besim në to sesa në institucionet e Kosovës. Ato institucione gjithashtu kanë më shumë të punësuar se homologët e tyre të Kosovës, gjë që do ta bëjë integrimin e tyre në buxhetin veçse të ngushtë të Kosovës edhe më të kushtueshëm.

Muajt e parë të vitit 2015 janë shënuar me frustrim nga të gjitha anët. Për pjesën më të madhe të kësaj periudhe në Kuvend ishin të pranishëm vetëm dy deputetë serbë të Kosovës, Nenad Rashedi dhe Slobodan Petroviq. Anëtarët tjerë të Listës Srpska bojkotuan pjesëmarrjen e tyre pas shkarkimit të ministrit Jablanović të 3 shkurtit 2015.

Komunat serbe të Kosovës në veri i kanë të bllokuara llogaritë e tyre meqë kanë refuzuar ta përfshijnë arsimin dhe kujdesin shëndetësor në propozimet e tyre buxhetore komunale, që është parakusht sipas udhëzimeve buxhetore të Qeverisë së Kosovës. Kjo ka qenë temë e disa raundeve të negociatave, madje edhe me përfshirjen e Bashkimit Evropian dhe ambasadës amerikane dhe sipas një diplomati perëndimor kjo “ndoti ujërat veçse të turbullta”.¹⁸

Këto komuna presin që Asociacioni /Bashkësia e ardhshme e Komunave me Shumicë Serbe do ta mbikëqyrë arsimin dhe kujdesin shëndetësor dhe ato nuk do të kenë nevojë për linja buxhetore komunale, ndonëse ministrja Edita Tahiri, kryenegociatore për Kosovën, është e bindur se “vështrimi” është i ndryshëm

¹⁶ Për më shumë informata ju lutem shihni “Emigrantët kosovarë këmbëjnë mizerien me pa-siguri,” Balkan Insight, 17 shkurt 2015. <http://www.balkaninsight.com/en/article/kosovar-migrants-trade-misery-for-uncertainty>

¹⁷ Për më shumë informata, shih “Deklarata kontroverze e Ministrit Murati dhe reagimet pasuese,” ECMI Kosovo, 5 mars 2015. <http://www.ecmikosovo.org/?p=6169>

¹⁸ Intervistë, prill 2015, Prishtinë.

nga “mbikëqyrja” dhe se Asociacioni nuk do të ketë kapacitete ekzekutive¹⁹. Së bashku, të katër komunat kanë kërkuar afro 60 milionë euro më shumë se që kishte planifikuar t’i ndajë buxheti i Kosovës, duke cekur zotimet e Tahirit për fonde të infrastrukturës.

Njoftimi në shkurt i një marrëveshjeje mbi gjyqësorin dhe vizita e përfaqësueses së lartë Mogherini në rajon mund të ndihmojnë që të injektohet një dinamikë e re në dialog.

Marrëveshja për shpërbërjen e trupave të Mbrojtjes Civile, e paralajmëruar gjatë vizitës së Mogherinit është gjithashtu inkurajuese. Kosova do të përfshijë pak më shumë se gjysmën e punonjësve të tanishëm në agjencitë e saj të menaxhimit të emergjencave. Kjo do të kontribuojë në zbutjen e drojës së serbëve se do t’i humbasin vendet e tyre të punës dhe frikën e shqiptarëve të Kosovës për njerëzit e organizuar me uniforma dhe armë.

Megjithatë, përvjetori i dytë i marrëveshjes së 19 prillit gjithashtu nënkupton që kanë kaluar dy vjet pa ndonjë marrëveshje vërtetë të re. Palët kanë arritur nën-marrëveshje në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Brukselit, por nuk kanë hyrë në negociata të reja. Disa zyrtarë kanë filluar në heshtje të pyesin nëse marrëveshjet e reja janë me të vërtetë në horizont. Me nivelin e angazhimit të BE-së, para vizitës së përfaqësueses së lartë Mogherini në rajon, marrëveshjet e reja janë jashtë diskutimit, tha një zyrtar me kusht anonimiteti duke shfaqur ankesë në lidhje me perceptimin se dialogu Kosovë-Serbi më nuk është prioritet i BE-së.

Për më tepër, çështje të tjera që për një kohë palët theksonin se janë afër marrëveshjes mbesin të pazgjidhura. Për muaj të tërë përfaqësues të qeverive të Kosovës dhe Serbisë kanë thënë se janë në prag të marrëveshjes për pranimin reciprok të sigurimeve. Megjithatë, pas muajve të kaluar ende nuk ka marrëveshje dhe kosovarët dhe serbët paguajnë pagesa të larta për sigurime – apo nuk udhëtojnë fare për shkak të kostos.

Ngjashëm, Qeveria e Kosovës premtoi një zgjidhje për çështjen e mbetur të kodit të telekomunikacionit më 1 janar të vitit 2015. Megjithatë, Kosova ende nuk ka kod të shtetit dhe njerëzit që përdorin prefiks të shtetit Monako +377 nuk mund t’i përdorin telefonat e tyre në Serbi për roaming.

Ka pasur pak progres në kopjimin e dokumenteve kadastrale, por ai ka qenë i vogël, gjersa zyrtarët serbë theksuan se ajo mund të zhbëhet varësisht nga agjencia që do të krijojë Qeveria e Kosovës për t’i verifikuar kopjet që Serbia do t’i dërgojë në Kosovë përmes EUSR-së.

¹⁹ Intervistë, Edita Tahiri, Prishtinë, prill 2015.

Marrëveshjet

Kur negociatori i Beogradit, Borko Stefanović, i cili atëkohë shërbente si drejtor politik në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Serbisë dhe zëvendëskryemini i Kosovës Edita Tahiri, filluan takimet në mars të vitit 2011, ishte hera e parë që Serbia dhe Kosova kishin hyrë në negociata që prej shpalljes së pavarësisë së Kosovës më 2008. Takimet ishin rregullisht lajme kryesore dhe ata ishin tejet jopopullorë para popullit të tyre në vendlindje. Negociatorët nënshkruan marrëveshjet e para po atë korrik. Në të njëjtin muaj, dhuna u ndez përgjatë kufirit kur Policia e Kosovës u përpoq t'i marrë nën kontroll pikat kufitare dhe t'i aplikojë procedurat e Doganave të Kosovës për mallrat që vinin përmes tyre. Paqeruajtësit e NATO-s u desh të ndërhynin për ta stabilizuar gjendjen. Një pjesëtar i Policisë së Kosovës, Enver Zymberi, u vra gjatë përpjekjes për ta marrë kontrollin e pikave në kufirin verior. Gjashtë të tjerë u plagosën.

Gjatë raundit teknik të të ashtuquajturit "dialog", palët nga Kosova dhe Serbia ranë dakord si në vijim, përmbledhur dhe paraqitur në mënyrë kronologjike²⁰:

Liria e lëvizjes²¹

Më 2 korrik 2011, të dyja palët janë pajtuar që banorët e të dyja vendeve duhet të jenë në gjendje të udhëtojnë lirshëm "brenda apo përmes territorit të njëra-tjetrës". Kjo do të lehtësohet nga një sistem i letërnjoftimeve për udhëtim 'ndërmjet kufijve/kufijve administrativë' të banorëve të palës tjetër, me përdorimin e dokumenteve të hyrjes/daljes. Secila palë është pajtuar që t'u mundësojë banorëve të palës tjetër që të udhëtojnë lirshëm brenda ose përmes territorit të njëra-tjetrës. Palët gjithashtu janë pajtuar për zgjidhje të përkohshme për blerjen e sigurimit të përkohshëm, ndërsa do të punohet drejt një marrëveshjeje komerciale për sigurimin e ndërsjellë të automjeteve.

pjesërisht i përfunduar

Regjistri civil²²

Gjithashtu më 2 korrik 2011, të dyja palët janë pajtuar që një komitet trepalësh i përbërë nga ekspertë të regjistrimit civil nga të dyja palët dhe i kryesuar nga Misioni i BE-së për Sundim të Ligjit, EULEX, do t'i identifikojë zbrazëtitrat në librat e gjendjes civile para vitit 1999. Serbia është pajtuar që të bëjë kopje të regjistrave origjinalë, të cilat, pas certifikimit nga EULEX-i, do të kthehen në Kosovë.

i përfunduar

pak progres

Kadastra²³

Më 2 shtator 2011, palët janë pajtuar të sigurojnë një regjistër të plotë kadastral për Kosovën përmes një procesi të ngjashëm me atë të përcaktuar në marrëveshjen për gjendjen civile: ekipet trepalëshe, të drejtuar nga BE-ja, do të analizojnë dhe verifikojnë dokumentet para vitit 1999. Secili do të krahasohet nga një agjenci teknike brenda Kosovës dhe në raste të mospërputhjes, do të trajtohen nga një mekanizëm gjyqësor, ku Gjykata Supreme e Kosovës do të veprojë si shkallë e dytë e apelit.

i përfunduar

Vulat Doganore²⁴

Më 2 shtator 2011, palët gjithashtu janë pajtuar t'i pranojnë vulat doganore të Kosovës dhe kanë premtuar që të sigurojnë liri të lëvizjes për mallrat në përputhje me CEFTA-n, Marrëveshjen e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë²⁵.

nuk ka progres

Pranimi i ndërsjellë i diplomave²⁶:

Më 21 nëntor 2011, të dyja palët janë pajtuar që të kërkojnë nga Asociacioni i Universiteteve Evropiane që t'i vërtetojë diplomat universitare për përdorim nga njëra-tjetra, qoftë për arsim të lartë qoftë për punësim në sektorin publik. BE-ja ka theksuar se do të bëjë përpjekje për të filluar zbatimin deri në janar të vitit 2012.

pak progres

IBM²⁷

Në kontekstin e BE-së, IBM nënkupton "Menaxhimin e Integruar të Kufirit" dhe është komponent kyç për anëtarësim. Meqë Serbia nuk e njeh Kosovën, ajo preferon termin "Menaxhim i Integruar i Kufijve Administrativë²⁸". Gjatë negociatave është përdorur vetëm termi 'IBM', i cili është neutral ndaj statusit. Më 2 dhjetor 2011, palët kanë rënë dakord që të aplikojnë konceptin e BE-së për IBM, duke u pajtuar që gradualisht të ngrenë pika të përbashkëta kufitare "sa më shpejt që praktikisht të jetë e mundur". Ato janë pajtuar që të ketë një prani të balancuar të stafit të secilës palë dhe të mos shfaqin simbole shtetërore. Palët gjithashtu janë pajtuar që zyrtarët e EULEX-it do të jenë të pranishëm në gjashtë vendkalimet kufitare.

20 Teksti i plotë i marrëveshjeve mund të gjendet në faqen e internetit të qeverisë së Kosovës: <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,191> dhe atë të Serbisë: <http://www.srbija.gov.rs/kosovo-metohija/index.php?id=82315>.

21 http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/agreement_0210_freedom.pdf

22 http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/agreement_0210_civil_books.pdf

23 http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/agreement_0210_cadastral_records.pdf

24 Teksti i plotë: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/agreement_0210_customs.pdf

25 Më 2006, Serbia, në kuadër të CEFTA, pranoi Kosovën si hapësirë të pavarur doganore.

26 Teksti i plotë: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/agreement_0210_university_diplomas.pdf

27 Teksti i plotë: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/agreement_0210_ibm.pdf

28 Gjersa Kosova e quan vijën ndërmjet vetes dhe Serbisë kufi, Serbia e quan atë si kufi administrativ.'

Përfaqësimi dhe bashkëpunimi rajonal²⁹

Më 24 shkurt 2012, palët kanë rënë dakord, që për një periudhë të përkohshme, emri i Kosovës të mund shfaqet me një asterisk në organe rajonale, me një fusnotë që i referohet Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe Opinionit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, GjND, për shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Më tutje ato janë pajtuar që çdo marrëveshje e re do ta paraqesë Kosovën me asterisk.

pak progres

Telekomi³⁰

Më 8 shtator 2013, palët kanë rënë dakord se BE-ja dhe Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit do t'i ndajë Kosovës kodin e saj treshifror telefonik dhe do t'i largojnë tri përdorimet e Kosovës (për linjën tokësore të Serbisë dhe Sllovenisë dhe të Sllovenisë dhe Monakos për mobil) nga janari i vitit 2015. Palët gjithashtu kanë rënë dakord që të harmonizojnë spektrin për Sistemin Global për Komunikim Mobil (GSM) dhe sinjalet televizive, ku të dyja palët janë pajtuar që të mos shkelin qëllimisht "kufirin / kufirin administrativ" të njëra-tjetrës.

nuk ka progres

Energjia³¹:

Palët janë pajtuar që organet e tyre të bartjes së energjisë, KOSTT nga Kosova dhe EMS nga Serbia, do të nënshkruajnë një marrëveshje dypalëshe brenda tre muajve për të vendosur dhe rregulluar marrëdhëniet në mes të dy operatorëve të sistemit të transmissioinit. Është pritur që të dy rregullatorët të lëshojnë licenca për tregtim (import, eksport, transit) dhe furnizim të kompanive të tyre përkatëse të shpërndarjes. Palët gjithashtu janë pajtuar që të krijojnë një kompani të re sipas ligjeve të Kosovës e cila do të ofrojë shërbime të shpërndarjes në komunat veriore me shumicë serbe. Kosova dhe Serbia gjithashtu u pajtuan që në një kohë të ardhshme të gjejnë një metodë të përbashkët për zgjidhjen e kërkesë-padive që të dyja palët kanë ushtruar ndaj tjetrës për përdorimin e linjave të transmissioinit, duke rënë dakord që të kërkojnë arbitrim ndërkombëtar nëse nuk gjendet zgjidhja brenda gjashtë muajve.

pjesërisht i përfunduar

Secila marrëveshje kërkonte një plan zbatimi³² dhe një komision të zbatimit

²⁹Tekstii i plotë: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/agreement_0210_representation.pdf

³⁰ http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Arrangements_regarding_Telecommunications_September_8_2013.pdf

³¹ http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Arrangements_regarding_Energy_September_8_2013.pdf

³² Plani i zbatimit për marrëveshjen e 19 prillit 2013 është këtu: <https://s3.eu-central-1.amazonaws.com/euobs-media/0807580ad8281aefa2a89e38c49689f9.pdf>

për të mbikëqyrur progresin e saj.

Baronesha Catherine Ashton, ish-përfaqësuese e lartë mbledhi të dy kryeministrat në një vend për t'u pajtuar mbi "Marrëveshjen e Parë për Parimet që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve", të nënshkruar më 19 prill 2013³³. Ajo përmbante marrëveshjet në vijim:

i përfunduar

Themelimi i katër komunave

Palët kanë rënë dakord që zgjedhjet komunale të organizohen në katër komunat veriore në vitin 2013 me lehtësimin e OSBE-së, në përputhje me ligjet e Kosovës dhe standardet ndërkombëtare.

nuk ka progres

Asociacioni /Bashkësia e Komunave Serbe

Palët janë pajtuar që sapo të kenë përfunduar zgjedhjet, do të themelohet Asociacioni/ Bashkësia e dhjetë Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, e cila do të ketë mbikëqyrje të plotë mbi fushat e zhvillimit ekonomik, arsimit, shëndetësisë, planifikimit urban dhe rural" dhe kompetenca të tjera të deleguara nga autoritetet qendrore. Anëtarësimi në të është i hapur për çdo komunë tjetër për aq kohë sa të gjithë anëtarët janë dakord. Ajo do të themelohet mbi të njëjtën bazë sikurse statuti ekzistues i Asociacionit të komunave të Kosovës. Komunat pjesëmarrëse "do të kenë të drejtë të bashkëpunojnë në ushtrimin e kompetencave të tyre përmes Asociacionit/Bashkësisë në mënyrë kolektive", në përputhje me Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale dhe ligjeve të Kosovës. Ky organ do të ketë rol përfaqësues tek autoritetet qendrore dhe do të ketë një ulëse në këshillin konsultativ të komuniteteve për këtë qëllim.

nuk ka progres

Policia dhe siguria

Policia e Kosovës, PK, do të jetë policia e vetme që vepron në territorin e Kosovës. E tërë policia në Kosovën veriore do të integrohet në PK dhe pagat do të paguhet nga ai organ. Pjesëtarëve të strukturave të tjera serbe të sigurisë do t'u ofrohet një vend në strukturat ekuivalente kosovare.

Një komandant rajonal do të mbikëqyrë të katër komunat veriore me shumicë serbe (Mitrovicë e veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq).Komandanti

pjesërisht i përfunduar

³³ Versioni zyrtar i të gjitha marrëveshjeve është në anglisht. Ky dokument është në dispozicion në faqen e internetit të qeverisë së Kosovës: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/FIRST_AGREEMENT_OF_PRINCIPLES_GOVERNING_THE_NORMALIZATION_OF_RELATIONS,_APRIL_19,_2013_BRUSSELS_en.pdf dhe faqen e qeverisë së Serbisë:

do të jetë serb, i emëruar nga Ministria e Punëve të Brendshme të Kosovës “nga lista e siguruar nga katër kryetarët e komunave në emër të Asociacionit/Bashkësisë”. Përbërja e njësisë rajonale do ta reflektojë përbërjen etnike të katër komunave. Do të jetë një komandant i veçantë rajonal për Mitrovicën e Jugut, Skenderajn dhe Vushtrinë, por komandanti rajonal i njësisë që mbulon të katër komunitatet veriore do të bashkëpunojë me komandantët e tjerë rajonalë.

Gjyqësori

Palët janë pajtuar që autoritetet ekzistuese gjyqësore do të integrohen në sistemin e Kosovës. Gjykata e Apelit në Prishtinë do të krijojë një trup të përbërë nga një shumicë e gjyqtarëve serbë të Kosovës që do të merret me të gjitha komunitatet me shumicë serbe.

Një divizion i kësaj Gjykate të Apelit, i përbërë nga staf administrativ dhe gjyqtarë, do të vendoset në mënyrë të përhershme në Mitrovicën Veriore. Gjyqtarët serbë të Kosovës do të përbëjnë shumicën e secilit panel.

Më 10 shkurt 2015 të dyja palët u takuan në Bruksel dhe u pajtuan saktësisht se si do të duket struktura e gjyqësorit. Palët kanë rënë dakord që kryetari i gjykatës do të jetë serb nga veriu i Kosovës. Gjykata në veri të Mitrovicës do të ketë një divizion të apelit me pesë gjyqtarë serbë dhe 2 gjyqtarë shqiptarë, ndërsa një serb do të emërohet nënkryetar i gjykatës së apelit në Prishtinë. Ajo gjithashtu do të akomodojë Divizionin e Krimeve të Rënda për të gjithë rajonin që do të përbëhet nga katër gjyqtarë serbë të Kosovës dhe katër gjyqtarë shqiptarë të Kosovës. Ka edhe numra specifikë të punëtorëve serbë e shqiptarë të përcaktuar për secilën gjykatë dhe degët e saj.³⁴

pak progres

Të tjera

Të dyja palët gjithashtu janë pajtuar që diskutimet për energji dhe telekom do të intensifikohen nga të dyja palët dhe do të përfundojnë deri më 15 qershor 2013.

pjesërisht i përfunduar

Të dyja palët janë pajtuar që asnjëra palë nuk do të blloktojë, apo inkurajojë të tjerët të bllokajnë progresin e palës tjetër në rrugët përkatëse drejt BE-së.

pak progres

Së fundi, palët janë pajtuar që të krijojnë një komision të zbatimit, me lehtësimin e BE-së. Kryenegociatori i secilit vend do të udhëheqë komisionet

i përfunduar

³⁴ Kjo marrëveshje është publikuar në formën e saj të rrjedhur. Ministria e Drejtësisë së Kosovës e ka vënë në dispozicion për BIG DEAL, por nuk e ka publikuar tekstin e plotë të marrëveshjes online.

përkatëse të zbatimit. Ato do të mbikëqyrin punën e komisioneve të zbatimit që kanë të bëjnë me çdo çështje specifike.

Që nga marrëveshja e prillit 2013 ka pasur progres në zbatim, por nuk janë hapur tema të reja. Për të vazhduar normalizimin, palët duhet t'i fillojnë diskutimet për shpërbërjen e administratës tatimore të Serbisë në veri. Përveç kësaj, procesi i normalizimit do të vazhdojë të ndodhë së bashku me një varg privatizimesh të bizneseve të kërkuara edhe nga Prishtina, edhe nga Beogradi. Përderisa nuk është medoemos e lidhur me normalizimin, të dyja palët e shohin privatizimin e minierës “Trepça” në Mitrovicë, hidrocentralit të Gazivodës dhe Qendrës Skitare të Brezovicës si punëdhënës të mëdhenj në të ardhmen dhe lufta për punë do të ketë ndikim të ndjeshëm në procesin e normalizimit.

Liria e lëvizjes dhe mallrat

Liria e lëvizjes mes Kosovës dhe Serbisë ka qenë e kufizuar që nga lufta. Situata është përmirësuar në masë të madhe kur marrëveshja e nënshkruar më 2011 u bë operacionale në maj 2013, duke i lejuar kosovarët të kalojnë nëpër Serbi me letërnjoftime zyrtare të vendit. Kosovarëve u lëshohet një shkresë e cila duhet të kthehet me rastin e rihyrjes në Kosovë, si dhe për makinat e regjistruara në Kosovë dhe Serbi që të blejnë sigurim në pikën kufitare.

Në shtator të vitit 2014, qytetarëve të Kosovës u është dhënë mundësia që të fluturojnë përmes aeroportit të Beogradit “Nikola Tesla”, si dhe aeroportit të Nishit dhe u është hapur transiti nëpër vendkalimet kufitare shtesë të Serbisë me Hungarinë dhe Kroacinë, dhe pikave të transitit për Bullgarinë dhe Maqedoninë.

Nga viti 1999, UNMIK-u, Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë, ishte përgjegjës për lëshimin e letërnjoftimeve, dokumenteve të udhëtimit, targave të automjeteve³⁵ dhe për përfaqësimin e Kosovës në tregtinë ndërkombëtare. Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës nga Serbia më 2008, UNMIK-u i dha fund kësaj praktike. Kosova, tani e pavarësuar, filloi lëshimin e këtyre dokumenteve. Vulat doganore ku dikur shkruhej dogana e UNMIK-ut, u kthyen në dogana e Kosovës, gjë që rezultoi me një embargo mbi të gjitha mallrat e Kosovës. Pasaportat e Kosovës, simbol i shtetësisë së sapolindur, po ashtu u refuzuan. Banorët e Kosovës mund të hynin në Serbi me dokumente të lëshuara nga UNMIK-u, Serbia apo Jugosllavia. Udhëtimi me automjete personale ishte gjithashtu problematik: Serbia nuk pranonte patentë-shoferët e lëshuar nga UNMIK-u apo Kosova.

Marrëveshja e korrikut 2011 e bëri të mundur ligjërisht lirinë e lëvizjes. Megjithatë, për kosovarët dhe serbët kalimi në rastin më të mirë është i vështirë dhe në rastin më të keq tejet i kushtueshëm.

Qytetarët e Kosovës mund të udhëtojnë në Serbi duke përdorur letërnjoft-

³⁵ Këto targa kanë “KS” në ballë.

timet e tyre. Në hyrje ata marrin dokument të udhëtimit që lejon qëndrimin deri në 90 ditë. Ky dokument duhet të dorëzohet për të dalë nga Serbia.

Vazhdon të mos ketë zgjidhje për njerëzit që nuk janë nga Kosova e Shqipëria, shtetet e së cilëve nuk lëshojnë letërnjoftime³⁶. Nëse ata nuk kanë hyrë në Kosovë përmes Serbisë, ata nuk mund të hyjnë në Serbi përmes Kosovës. Këta shtetas të huaj duhet të hyjnë në Serbi përmes një vendi tjetër, si Maqedonia apo Mali i Zi, apo të fluturojnë përmes një shteti të tretë, duke e bërë udhëtimin e gjatë dhe shpeshherë më të shtrenjtë. BIG DEAL është informuar për raste kur persona nga shtete që nuk lëshojnë letërnjoftime kanë shfrytëzuar letërnjoftimet e Kosovës për të udhëtuar në Serbi, por që janë refuzuar në kufi, para intervenimit nga niveli i lartë.³⁷

Ngjashëm, BIG DEAL ka pranuar raportime se në raste të caktuara fëmijëve kosovarë që nuk kanë pasaporta u është refuzuar hyrja për shkak se certifikata e tyre e lindjes, që është dokumenti i duhur për të udhëtuar për në Serbi për personat nën moshën 18 vjeçe, ishte më e vjetër se 6 muaj. Serbia kërkon që certifikata e lindjes të përtërihet çdo gjashtë muaj dhe vula e autoriteteve të Kosovës të vendoset mbi fotografinë e fëmijës si dhe në certifikatë të lindjes. Kjo e bën procesin e kalimit të kufirit për familje tejet burokratik.

Më 26 mars 2015, Gjykata Kushtetuese e Serbisë shpalli rregulloren për pikat kufitare në mes të Kosovës dhe Serbisë³⁸ të qeverisë së Serbisë së nxjerrë në dhjetor 2011 si jokushtetuese. Gjykata theksoi se dekreti i qeverisë së dhjetorit 2011 ishte shkelje e integritetit territorial të Serbisë. Megjithatë, gjykata refuzoi kërkesën për ndalimin e të gjitha aktiviteteve që janë duke u ndërmarrë në përputhje me dekretin.

Në të njëjtën kohë, Gjykata Kushtetuese konsideroi të papranueshëm një peticion për rishikimin e vendimit për pranimin e raportit të dialogut politik dhe teknik me Prishtinën të lehtësuar nga BE-ja.³⁹

Gjykata gjithashtu nuk pranoi të vlerësojë kushtetutshmërinë e konkluzioneve të qeverisë, të dorëzuar më 22 prill 2013 që miratonin "Marrëveshjen e Parë të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve mes Beogradit dhe Prishtinës" të 19 prillit 2013.

Sigurimi:

Ndonëse edhe Kosova edhe Serbia kanë thënë për BIG DEAL se një marrëveshje është shumë afër arritjes, ende nuk ka një pranim të ndërsjellë të sigurimit të automjeteve që është normë në shumicën e Evropës, e cila përdor Sistemin e Kartonit të Gjelbër. Çmimet e sigurimit vazhdojnë të jenë të larta



³⁶ Këto shtete nuk lëshojnë letërnjoftime: Australia, Kanadaja, Danimarka, Irlanda, India, Japonia, Zelanda e Re, Norvegjia, Mbretëria e Bashkuar dhe SHBA.

³⁷ Incident në mars 2015 në kalimin kufitar në Merdare.

³⁸ Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë, nr. 98/11. Në dispozicion këtu: <http://www.ustavni.sud.rs/page/view/sr-Latn-CS/80-102128/saopstenje-sa-8-sednice-ustavnog-suda-odrzane-26-mar-ta-2015-godine-kojom-je-predsavala-vesna-ilic-prelic-predsednica-ustavnog-suda>

³⁹ Parlamenti serb kurrë nuk i ka miratuar marrëveshjet Kosovë-Serbi si ligje, por në fakt ka miratuar raportin e qeverisë së Serbisë të dorëzuar më 22 prill 2013 për marrëveshjen. Partia Demokratike e Serbisë (DSS) kërkoi që të priset pranimi i raportit nga Gjykata Kushtetuese, por kjo e fundit e hodhi poshtë këtë kërkesë.

për të dyja palët: ata që hyjnë në Kosovë me targa serbe duhet të paguajnë 20 euro për një javë, 40 euro për 15 ditë, 80 euro për një muaj, dhe mbi 600 euro në vit⁴⁰. Në Serbi, paga mesatare mujore është midis 350 dhe 420 euro që do të thotë se ky është një shpenzim i konsiderueshëm. Ata që hyjnë nga vendet tjera duhet të paguajnë 30 euro për 15 ditë dhe 41 euro për një muaj.

Që nga tetori i vitit 2013, Qeveria e Kosovës paguan tarifën e shkaktuara nga shqiptarët etnikë që jetojnë në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc dhe që udhëtojnë në Kosovë. Qeveria ka shpenzuar më se dy milionë euro për këtë qëllim, sipas Ministrisë së Financave.⁴¹

Shoferët me targa të Kosovës që hyjnë në Serbi paguajnë 105 euro për një muaj të sigurimit, i vetmi opsion në dispozicion. Kjo është një tarifë e konsiderueshme duke pasur parasysh pagën mesatare mujore në Kosovë prej 416 eurosh⁴². Kosovarët duhet t'i blejnë targat e përkohshme – "PROBA", të cilat kushtojnë 5 euro shtesë për çdo ditë të udhëtimit. Kjo do të thotë që të gjitha udhëtimet duhet të planifikohen paraprakisht për të parashikuar numrin e ditëve të kaluara në Serbi.

Ky proces është tejet i ndërlikuar në pikën veriore kufitare të Jarinjës, ku sigurimi për Serbinë nuk shitet në pikën e kalimit. Personat me targa "RKS" apo Republika e Kosovës duhet t'i lënë makinat e tyre në pikën e kontrollit, të ecin në këmbë apo të shkojnë me autostop 1.5 kilometra për ta blerë sigurimin dhe pastaj të kthehen para se të mund të hyjnë në Serbi.

Këshilli i Byrove, organizatë e menaxhimit të sistemit shumëpalësh të Kartonëve të Gjelbër që përdoren në të gjithë Evropën, shërben si ndërmjetëse në diskutimet mes Kosovës dhe Serbisë. Burime të afërta me diskutimet kanë theksuar me muaj të tërë se një marrëveshje është pothuajse gati. Megjithatë, duket se ky ajo është "aq afër, por aq larg."

Në një intervistë në vjeshtë të vitit 2014, ministrja Edita Tahiri tha se priste që deri në janar 2015 të aplikohen çmime më të ulëta të sigurimit.

Transiti dhe udhëtimi ajror:

Më 16 shtator 2014 të dyja palët u pajtuan që kosovarët të lejohen të udhëtojnë nëpër Serbi përmes pikave të reja transite me Bullgarinë dhe Maqedoninë, krahas pikave ekzistuese në Kroaci dhe Hungari. Kjo marrëveshje hyri në fuqi më 16 nëntor 2014. Në shtator 22, në bazë të së njëjtës marrëveshje, qytetarët e Kosovës ligjërisht mund të fluturonin brenda dhe jashtë aeroportit ndërkom-bëtar të Beogradit.

Udhëtimi me tren:

Udhëtimi me tren ende nuk është diskutuar në Bruksel. Pasi UNMIK-u përfundoi drejtimin e sistemit të hekurudhave më 2008, Serbia mori kontrollin

⁴⁰ Çmimet janë në dispozicion në: <http://www.bks-ks.org/static/uploads/publications/tarifat/tarifa0.png>

⁴¹ Që nga 31 marsi 2015, gjithsej pagesat ishin 1,813,903.00 euros.

⁴² <http://wiiw.ac.at/kosovo-overview-ce-23.html>

e mbi 50 kilometrave të hekurudhës në Kosovën Veriore nga Zvecani për në Leshak. Që nga tetori i vitit 2013, hekurudha e Serbisë operon me një tren nga Mitrovica e Veriut për në Kratëvë me lidhje me Beogradin dhe më gjerë. Ky tren nuk është nën kontrollin e Prishtinës dhe zyrtarë qeveritarë të Kosovës kanë shprehur frustrimin e tyre që hekurudhat e Serbisë nuk paguajnë për shfrytëzimin e linjës hekurudhore të cilën e konsiderojnë si pronë të Kosovës.

Ura mbi lumin Ibër

Qeveria e Kosovës vazhdon të jetë e shqetësuar për barrikadën mbi lumin Ibër, e cila pengon lëvizjen e lirë të njerëzve nga veriu në jug, ndonëse ka ura të tjera që lehtësojnë lëvizjen. Protestat shpërthyen në qershor 2014 pasi që barrikadat në anën veriore u larguan përkohësisht. Mbi urë u vendos i ashtuquajtur i "Parku i Paqes" në vend të barrikadës së mëparshme, rrugët janë gërryer, duke bërë dëme shumë më të rënda.

EUSR-ja është angazhuar aktivisht dhe është zotuar të paraqesë një raport për zbatueshmërinë e shpërbërjes së barrikadës gjatë muajve në vijim.

Dogana dhe tregtia e lirë

"Ne kemi shumë më shumë probleme që nga fillimi i dialogut. Institucionet e Kosovës theksojnë se që nga muaji maj do të jetë e pamundur të importohen ilaçe nga prodhues të Serbisë të cilët nuk regjistrohen në Kosovë. Nëse nuk e rregullojmë këtë, të gjithë do të shkojmë në kolaps të plotë."

Milan Ivanović, drejtor, Qendra Klinike në Mitrovicën Veriore

Serbia dhe Kosova arritën një marrëveshje për vulat doganore dhe tregtinë e lirë më 2 shtator 2011. Zbatimi filloi në fund të të njëjtit muaj, ndonëse nuk është zbatuar në pikat e kalimit në veri, në Jarinjë dhe Bërnjak, deri në dhjetor 2013. Marrëveshja është e bazuar në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë në Evropën Qendrore, CEFTA, në të cilën vendet e Evropës juglindore që nuk janë anëtare të BE-së janë palë nënshkruese. Marrëveshja largoi një embargo trevjeçare tregtare mbi mallrat e Kosovës dhe tregtia është rritur, edhe pse është tejet e njëanshme.

Odat ekonomike të Kosovës dhe Serbisë kanë qenë aktorët kryesorë në këtë segment të dialogut, duke u takuar rregullisht për të rënë dakord mbi detajet e marrëveshjeve teknike për të mundësuar lëvizjen e lirë të mallrave, veçanërisht duke trajtuar tema të vështira siç janë edhe shqetësimet fitosanitare. Kjo tregon se kur të dyja palët kanë interesa të njëjta në rezultat, ato janë më të hapura në këmbim që pastaj sjellë rezultate pozitive.

Vëllimi i tregtisë është rritur në masë të madhe: Nga viti 2013 deri 2014 eksportet e Kosovës në Serbi u rritën për 185 për qind, nga 7.7 milionë euro në 22.5 milionë euro. Megjithatë, vazhdon të ketë çekuilibrë të konsiderueshëm të tregtisë. Më 2014, Serbia ka eksportuar 368.24 milionë euro vlerë të mallrave në Kosovë, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës.

Më 14 dhjetor 2013, mbledhja e detyrimeve doganore nga Jarinjë dhe Bërnjaku filloi pa incidente. Sipas marrëveshjes, paratë nga këto pika shkojnë në



"Qeveria në Prishtinë dëshiron ta integrojë sistemin shëndetësor në veri, siç e bëri me policinë dhe gjyqësorin, por kjo nuk do të mund të ndodhë në një afat të shkurtër pa kushte të konsiderueshme dhe rrethana të paparashikueshme për pacientët dhe publikun e gjerë"

— BLAGOJE SAVIQ, PRONAR I FARMACISË

një Fond Zhvillimor për Veriun. Fondi aktualisht ka pesë milionë euro, ndonëse ende nuk janë iniciuar projekte. Një zëdhënës i EUSR-së tha për BIG DEAL se bordi drejtues, i përbërë nga Ministri i Financave, një përfaqësues serb dhe Përfaqësuesi Special i BE-së i cili gjithashtu kryeson bordin, mbajti një takim konstruktiv gjatë marsit dhe fondet pritet të jenë funksionale "shumë shpejt".

Procesi vazhdon për importin e mallrave të kontrolluara, apo mallrave të cilat duhet të licencohen. Fillimisht, një periudhë tranzicioni tre muajsh që filloi nga dhjetori 2013 u aplikua për këto mallra, të cilat përfshijnë produktet farmaceutike dhe furnizime të tjera. Afati për të zgjidhur këtë problem ishte deri më 31 dhjetor 2014, por tani licencimi është zgjatuar përsëri deri më 1 qershor 2015. Licencimi i produkteve medicinale, në veçanti atyre të prodhuara në Serbi nga kompanitë shtetërore, do të vazhdojë të jetë problem, meqë sistemi shëndetësor serb nuk do të funksionojë pas 1 qershorit 2015 e tutje dhe ata mjekë me gjasë nuk do të mund t'i përshkruajnë ilaçet serbe për pacientët. Nëse nuk do të përmbushet afati i majit të vitit 2015, disa ilaçe do të jenë në dispozicion vetëm nëse pacientët udhëtojnë në Serbi.

Drejtori i Qendrës Klinike në Mitrovicë të Veriut Milan Ivanović tha për BIG DEAL se kjo mund të krijojë një katastrofë të shëndetit publik.⁴³

"Ne kemi më shumë probleme që nga nisja e dialogut," theksoi ai. "Institucionet e Kosovës thonë se nga maji do të jetë e pamundur të importohen ilaçe nga prodhues të Serbisë të cilët nuk regjistrohen në Kosovë. Nëse nuk rregullohet kjo çështje, do të hyjmë në një kolaps të plotë."

Tranzicioni prek edhe bizneset.

"Qeveria në Prishtinë dëshiron ta integrojë sistemin shëndetësor në veri, siç e bëri me policinë dhe gjyqësorin, por kjo nuk do të mund të ndodhë në një afat të shkurtër pa kushte të konsiderueshme dhe rrethana të paparashikueshme për pacientët dhe publikun e gjerë", tha Blagoje Saviq, një pronar i një farmacie në Mitrovicë, për BIG DEAL.

"Spitalet dhe qendrat shëndetësore në zonat me shumicë serbe do të funksionojnë si pjesë e sistemit shëndetësor të Serbisë deri më 2018 dhe për sa kohë sa do të jetë kështu, mjekët do të përshkruajnë ilaçe të listuara në Agjencinë e Serbisë për Produkte Medicinale, meqë çdo veprim ndryshe do të ishte shkelje e ligjit. Ndërkohë, si farmacistë, ne kemi nevojë për produkte nga kompanitë farmaceutike serbe, por nuk do të mund të mbulojmë as edhe 10 për qind të nevojave tona në lidhje me ilaçet", tha Saviq.

Saviq është i shqetësuar sepse diçka tjetër që duhet të bëjë është që produktet farmaceutike të tij të jenë në pajtim me udhëzimet e Kosovës është që diplomat e farmacistëve të tij që kanë studiuar në Serbi të pranohen. Megjithatë, ky proces ka stagnuar në tërësi.⁴⁴

Një tjetër biznesmen në veri të Kosovës u ankua se nëse ai importon mallra në veri të Kosovës, nuk është në gjendje t'i shesë këto produkte në jug të lumit

⁴³ Intervistë, Qendra Klinike në Mitrovicë të Veriut, prill 2015.

⁴⁴ Për informata të plota, shih pjesën e diplomave më poshtë.

Asociacioni/Bashkësia e Komunave me Shumicë Serbe

Në fund të muajit marsi 2015, përfaqësuesit kryesorë serbë nga e tërë Kosova mbajtën një takim jozyrtar konstitiuv në Graçanicë. Pjesëmarrësit në takim nxorën dhjetë konkluzione për të ardhmen e përfaqësimit politik serb në Kosovë



Regjistrim të popullsisë në zonat serbe, meqë serbët bojkotuan regjistrimin e fundit të popullsisë në Kosovë. Kjo do të mundësonte që ndarjet buxhetore të bëhen në baza reale dhe jo të parashikuara.




Përfaqësuesit janë pajtuar që komuniteti serb duhet të përfaqësohet politikisht në të gjitha komunat, përfshirë edhe



Mbrojtje e plotë për pronën e Kishës Ortodokse Serbe.



Lirimi i menjëhershëm i njerëzve të quajtur "të burgosur politikë".



Kthimi në Kosovë i të gjithë serbëve të zhvendosur.



Vendimet ligjore që ndikojnë në komunitetin serb duhet të gëzojnë pëlqimin e plotë paraprak të përfaqësuesve të zgjedhur politikë serbë në Kosovë, theksohej në një pikë tjetër.



Kërkesë për njohjen e licencave të Odës së Avokatëve të Serbisë



Ndalim i privatizimeve të mëtejshme dhe hetim i keqbërjeve në procesin e privatizimit deri tani.



Mbështetje e plotë për një "Asociacion të fortë të Komunave Serbe".

nuk ka progres

Pranimi i ndërsjellë i diplomave



Telekomi



Asociacioni /Bashkësia e Komunave Serbe

Kadastra



IBM

Përfaqësimi dhe bashkëpunimi rajonal

Gjyqësori



Liria e lëvizjes

Energjia

Policia dhe siguria



pjesërisht kompletuar

Vulat Doganore

Themelimi i katër komunave

Librat amë

Komisioni për përgatitjen e marrëveshjes

i përfunduar

lbër, gjersa tregtarët që jetojnë në jug të lumit mund të shesin në veri.

“Prishtina po provon të krijojë një zonë të vdekur nga veriu”, tha ai për BIG DEAL. “Me këto dogana, kostoja jonë e jetesës është rritur, por fitimi im ka rënë në mënyrë drastike dhe unë nuk e di për sa kohë kjo do të jetë e qëndrueshme”.

Ndryshimet prekin serbët e Kosovës, posaçërisht ata në komunat veriore
“Nëse ka vullnet të mirë politik, ka edhe zgjidhje kreative.”, theksoi një zyrtar lokal për BIG DEAL. “Serbia ka bërë gjëra që janë në kundërshtim me kushtetutën e saj, dhe tani Prishtina ankohet se serbët janë duke thyer ligjin e saj mbi vetëqeverisjen lokale?”

Ndryshimet që ndikojnë te serbët e Kosovës, veçanërisht në komunat veriore

Në nëntor të vitit 2013, katër komunat veriore të Kosovës (Mitrovica e Veriut, Zveçani, Zubin Potoku dhe Leposaviqi) për herë të parë morën pjesë në zgjedhjet komunale të organizuara nga Prishtina, sipas Marrëveshjes së 19 prillit. Funkcionimi i tyre është rezultat i drejtpërdrejtë i angazhimit të Brukselit.

Të katër komunat konstituuan kuvendet e tyre në janar 2014 dhe përgatitën statutet e tyre komunale në maj të të njëjtit vit. Megjithatë, funksionimi i tyre vazhdon të jetë i brishtë dhe Prishtina mund të ketë kontroll de jure mbi veriun, por ndikimi në to në praktikë është i kufizuar dhe momentalisht jashtë binarëve.

Mosmarrëveshjet ndërmjet komunave dhe Prishtinës mbi atë se kush ka autoritet për financimin për arsim dhe shëndetësi, si dhe buxhetet e fryra komunale, bënë që katër komunat të kenë llogari të bllokuara që nga fillimi i marsit 2015.⁴⁵

Të katër komunat veriore në Kosovë prisnin të praninin buxhete komunale këtë vit nga qeveria në Prishtinë, nga disa milionë euro për secilën, të cilat sipas burimeve qeveritare ishin tri herë më shumë se që praninin vitin e kaluar.

Sipas përfaqësuesve në Prishtinë, këto komuna gjithashtu do të kenë qasje në fondet shtetërore prej 17 deri 20 milionë euro për projekte infrastrukturore. Por sipas ministrisë së financave dhe pushtetit lokal, ata kërkuan që financimi për katër komunat të jetë 59 milionë euro më i lartë se që ishte paraparë.

Mitrovica e Veriut, me 12.139 banorë, buxhetoi rreth 20 milionë euro, ndonëse vetëm 2.7 milionë euro janë miratuar nga qeveria. Leposaviqi, me 13.485 banorë, miratoi 11.5 milionë euro, ndërsa janë ndarë vetëm 2.3 milionë euro. Zveçani, me popullatë prej 7,300 banorësh, miratoi rreth 14 milion euro, ndërsa u ndanë 1.6 milionë; Zubin Potoku, me popullatë prej 6,500 banorësh, miratoi 21.5 milionë euro gjersa vetëm 1.8 milionë janë ndarë për të.⁴⁶

⁴⁵ Intervistë me Ksenija Bozoviq, shefe e Asamblesë Komunale të Mitrovicës së Veriut. Për më shumë shihni: <http://www.balkaninsight.com/en/article/prishtina-blocks-the-accounts-of-serb-municipalities>

⁴⁶ Shumica e serbëve bojkotuan regjistrimin e popullsisë më 2011 dhe kështu statistikën zyrtare, që janë baza për buxhete, nuk përfaqësojnë realitetin në terren. Në një dokument të lëshuar rishtazi, Grupi për Hulumtime të Politiikave në Ballkan vlerësoi popullatën serbe bazuar në një kombinim të burimeve, duke përfshirë vlerësimet e OSBE-së, Rezultatet e zgjedhjeve, regjistrimet në shkollat serbe, dhe më shumë. Sipas regjistrimit të vitit 2011, numri i popullsisë serbe është 12.000 në krahasim me vlerësimet e llogaritura prej 19.700 në Mitrovicën e Veriut, 13.485 në krahasim me 16.175 të llogaritur në Leposaviq, 7318 në krahasim me 14.575 të llogaritur në Zveçan, dhe 6508 në

Shuma e parave që Serbia jep për këto komuna është vështirë të dallohet: financimi serb për Kosovën nuk është tërësisht transparent. Megjithatë shumica e parave të premtuara për komunat veriore duket se është e barabartë, nëse jo më e lartë, se ajo për komunat e madhësisë së ngjashme në Kosovë. Nëse marrim parasysh regjistrimin e popullsisë së Kosovës Obiliqi me një popullsi prej 21 mijë e 500 banorësh mori 4.6 milionë euro në vitin 2014. Hanit të Elezit, me popullatë prej 9500 banorësh iu dhanë 1.8 milion, ndërsa Junikut me popullsi prej 6100 banorësh, 1.2 milionë euro.⁴⁷

Dragan Jablanoviq, kryetari i komunës së Leposaviqit, tha se ishin premtuar buxhete më të mëdha për komunat nga ana e ministres për Dialog, Edita Tahiri, e cila kryeson ekipin e Kosovës në dialogun e lehtësuar nga BE-ja mes Kosovës dhe Serbisë.

“Për shkak të faktit që ministritë përkatëse, si Ministria e Infrastrukturës dhe ministri të tjera nuk kanë investuar në komunat veriore më parë, Tahiri tha se do të mund të kërkojmë buxhete më të larta për investime kapitale për komunat tona”, tha Jablanoviq.

“Qeveria e Prishtinës dhe kuvendet komunale kanë mendime të ndryshme për mënyrën se si duhet të menaxhohet ky buxhet. Prishtina duhet të kuptojë se Mitrovica e Veriut nuk është vetëm një komunë, se ajo shërben si qendër administrative për pothuajse të gjithë serbët në Kosovë”, tha Adrijana Hoxhiq, shefe e Zyrës Administrative të Qeverisë së Kosovës për Mitrovicën e Veriut.⁴⁸

Për më tepër, tha ajo, kuvendet lokale besojnë se këto kompetenca duhet t’i takojnë Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe.

Një tjetër zyrtar komunal theksoi se nëse ka vullnet për të gjetur kompromis, do të ketë zgjidhje, por tha se në këtë rast nuk ka vullnet nga ana e Prishtinës.

“Nëse ka vullnet të mirë politik, ka zgjidhje kreative”, tha një zyrtar lokal për BIG DEAL. “Serbia ka bërë gjëra që janë në kundërshtim me kushtetutën e saj dhe tani Prishtina ankohet se serbët janë duke e shkelur ligjin e saj për vetëqeverisje lokale?”⁴⁹

Përveç kësaj çështjeje, është me rëndësi të kuptohet se qeverisja e këtyre komunave deri në fund të vitit 2013 ishte vetëm sipas sistemit serb. Tani ekziston një model hibrid, ku funksionojnë të dy sistemet, meqë sistemet serbe nuk janë mbyllur në tërësi. Për shembull, në veri të Mitrovicës, nënkryetari i komunës është kryetar i komunës sipas sistemit serb.

Strukturat paralele

Janë pikërisht këto pozita të dyfishta e të trefishta që janë njohur në Prishtinë si “struktura paralele”. Deri në nëntor të vitit 2013, strukturat kryesore që mbikëqyrnin qeverisjen, shëndetin, arsimin dhe kulturën ishin institucionet

krahasim 12.780 të llogaritur në Zubin Potok. Shih “Integrimi serb në Kosovë pas Marrëveshjes së Brukselit”, BPRG, mars 2015..

⁴⁷ Buxheti i Kosovës 2014

⁴⁸ Intervistë, mars 2015.

⁴⁹ Intervistë me një zyrtar serb në veri të Kosovës, mars 2015.

serbe. Tani, këto vazhdojnë të pranojnë financim nga Serbia dhe ato që pranojnë para nga buxheti i Kosovës ende marrin më shumë para nga Serbia.

Serbia ende i paguan punonjësit në të gjithë territorin e Kosovës përmes organeve të quajtura privremeno veçe, ose “këshilla të përkohshëm”. Sipas hulumtimeve nga gazetarët serbë, janë në total më shumë se 5.100 njerëz të zgjedhur ose të emëruar në listën e pagave të Serbisë të cilët punojnë në qeveri lokale apo ndërmarrje publike, përfshirë shkollat dhe spitalet në territorin e Kosovës në 29 komuna. Prishtina ka më së shumti njerëz, 840, ndërsa Mitrovica veriore ka 614, Leposaviqi 510, Zubin Potoku 399, dhe Zveçani ka 242⁵⁰. Disa nga këta njerëz zyrtarisht punojnë në institucionet e Kosovës dhe marrin dy paga. Të tjerët nuk kanë një vend pune nga ku mund të punojnë, apo nuk kanë çfarë të bëjnë, por vazhdojnë t’i marrin pagat e tyre.

Prishtina pretendon se ata janë “pengesa kryesore në procesin e normalizimit”⁵¹ të komunave veriore, por shumë serbë të Kosovës konsiderojnë se ato paga ua mundësojnë ata të kenë një jetë normale.⁵²

Këto janë mbetje të sistemit të Serbisë që përfundimisht do të zhvendosen të sistemi i Kosovës pasi të jetë përgatitur një plan për inkuorporimin e tyre dhe ata ose do të mund të marrin një vend pune, ose një pension. Një pjesë e kësaj ka ndodhur me integrimin e policisë dhe integrimin eventual të gjyqësorit. Ata që kanë mbetur, me përjashtim të trupave të Mbrojtjes Civile, mund të vazhdojnë të funksionojnë sipas sistemit serb për një kohë, meqë janë institucionet e vetme ekzistuese: përkohësisht, sistemet shëndetësore dhe arsimore të Serbisë do të vazhdojnë të funksionojnë në veri të Kosovës deri më 2018.



Asociacioni/Bashkësia e Komunave me Shumicë Serbe

Asociacioni i Komunave është një nga komponentët kryesorë të marrëveshjes së 19 prillit 2013: gjashtë nga 15 pikat e pajtimit kanë të bëjnë me krijimin e këtij organi. Ai shihet si elementi kyç për të ardhmen e sigurt të komunitetit serb të Kosovës, njëkohësisht duke mundësuar largimin përfundimtar të institucioneve serbe nga qeverisja në Kosovë.

Plani fillestar i zbatimit parashikonte që Asociacioni të themelohet deri në tetor 2013. Dy vjet pas marrëveshjes për krijimin e Asociacionit/ Bashkësisë, nuk është publikuar draft-statuti i këtij organi. Gjithashtu nuk ka marrëveshje mbi emrin e tij: disa dokumente i referohen si “Asociacioni i Komunave Serbe”, ndërsa të tjerët përdorin termin “Bashkësi”, ndërsa të tjerë preferojnë termin “Komunat me Shumicë Serbe”.

Asociacioni/Bashkësia pritet të përfshijë dhjetë komunat e Kosovës me shumicë serbe, katër komunat në veri të Kosovës si dhe në Graçanicën, Shtërpçën, Novobërdën, Kllokotin, Ranillugun dhe Parteshin, me qendrën rajonale për komunat jugore në Graçanicë.

50 Të dhënat e siguruar nga Ivan Angelovski, nga programi i B92 Insajder. Pagat për këta 5,106 njerëz i kushtojnë qeverisë së Serbisë gati 2.18 milionë euros në muaj.

51 Tahiri, “Gjendja me Marrëveshjet e Brukselit,” 2015, f. 10.

52 Intervistë, Mitrovicë e Veriut, shkurt 2015.

Sipas marrëveshjes, pasi të jetë themeluar Asociacioni/Bashkësia, ai/ajo do të ketë “mbikëqyrje të plotë mbi fushat e zhvillimit ekonomik, arsimit, shëndetësisë, planifikimit urban dhe rural” dhe kompetenca të tjera të deleguara nga autoritetet qendrore. Anëtarësimi i tij/saj është i hapur për çdo komunë tjetër me kusht që të gjithë anëtarët të jenë dakord.

Asociacioni/Bashkësia do të krijohet me statut, mbi të njëjtën bazë sikurse statuti ekzistues i Asociacionit të komunave të Kosovës, organ i lirë i komunave të Kosovës në jug të lumit Ibër. Komunat pjesëmarrëse “do të kenë të drejtë të bashkëpunojnë në ushtrimin e kompetencave të tyre përmes Asociacionit/Bashkësisë në mënyrë kolektive,” në përputhje me Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale⁵³ dhe ligjeve të Kosovës, veçanërisht kapitullin pesë të Ligjit për vetëqeverisje lokale dhe Ligjin për bashkëpunimin ndërkomunal. Ky organ do të ketë rol përfaqësues të autoritetet qendrore dhe do të ketë një ulëse në Këshillin Konsultativ të Komuniteteve për këtë qëllim.

Sipas këtyre ligjeve, komunat mbajnë autoritetin dhe përgjegjësinë përfundimtare për marrjen e vendimeve, ndërsa autoritetet qendrore nuk mund ta shqyrtojnë veprimtarinë e një asociacioni /bashkësie të ardhshme, por atë të komunave drejtpërdrejt⁵⁴. Në kuadrin ligjor ekzistues, komunave u lejohej të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën si dhe me ato të vendeve të tjera, ndonëse i gjithë bashkëpunimi është i rregulluar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL).

Forma e bashkëpunimit është ende e paqartë. Marrëveshja e 19 prillit 2013 përdor të dy termat “Asociacion” dhe “Bashkësi”. Prishtina preferon termin “Asociacion”, duke lidhur strukturën me atë të Asociacionit tashmë ekzistues të Komunave të Kosovës (AKK), ndërsa serbët përdorin vetëm termin “Bashkësi” kur të diskutojnë për këtë organ⁵⁵. Edhe përdorimi i këtyre termave mbarë prirje të ngarkuara për të dyja komunitetet, ku serbët presin më shumë autonomi dhe shqiptarët presin një organizim më të lirë të ngjashëm me atë të AKK-së ekzistuese. Ndërkohë vazhdon konfuzioni mbi atë nëse trupi do të marrë formën juridike të një “partneritet komunal” apo të “asociacioni të komunave”⁵⁶. Me gjasë përfundimi do të jetë një model hibrid, i bazuar në organizimin e AKK-së, me disa shtresa të përfaqësimit (një bord ekzekutiv, këshill të kryetarëve të komunave, dhe një asamble), por me kapacitet më të gjerë që i jepet partneriteteve komunale. Kjo nuk do ta përjashtojë financimin nga Serbia, i cili është ligjor sipas ligjeve të Kosovës, me kusht që MAPL të njoftohet paraprakisht për çdo bashkëpunim ndërkufitar, duke përfshirë buxhete, plane të punës dhe objektiva transparente. Megjithatë, sipas Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nëse ministria gjen dëshmi që është shkelur ligji, ajo do të tërheqë autoritetin për ndryshimin e statutit apo do të ndalojë marrëdhënien.

Këto janë disa arsye pse Statuti vazhdon të jetë tejet kundërshtues, ku

53 Teksti i plotë: <http://conventions.coe.int/Treaty/en/Treaties/Html/122.htm>

54 Shih “Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbe: çka wshwt e (pa)mundur sipas kuadrin ligjor?” Adrian Zeqiri dhe Pieter Troch, 16 prill 2015. <http://www.ecmikosovo.org/?p=6242>

55 Në shqip, “asociacioni.” Serbët nuk përdorin termin “asocijacija,” preferojnë “zajednica.”

56 Për më shumë shih raportin e ECMI të cekur më lartë.

shqiptarët e Kosovës kanë shqetësime se kjo do t'i ngjasojë Republika Srpskas në Bosnje dhe Hercegovinë, e cila ka qenë forcë decentralizuese dhe destabilizuese në BeH. Serbët e Kosovës janë të shqetësuar se ai mund të bëhet një trup i pafuqishëm. Në të vërtetë, Qeveria e Kosovës e ka paraqitur atë para qytetarëve të saj si një lloj OJQ-je, ndërsa në fushatën zgjedhore për zgjedhjet e nëntorit 2013 serbët në komunat veriore u inkurajuan që të marrin pjesë në zgjedhjet e organizuara nga Prishtina duke thënë se një votë për partinë ishte votë për krijimin "Srpskas", duke iu referuar Republika Srpskas.⁵⁷

Krijimi i Asociacionit brenda tri deri në pesë muajve ishte një nga komponentët e marrëveshjes së koalicionit midis Listës Srpska, PDK-së dhe LDK-së që nënkuptonte më së voni deri në maj 2015. Megjithatë, liderët serbë kaluan pjesën më të madhe të kohës jashtë qeverisë. Pas shkarkimit të Ministrit për Komunitete dhe Kthim, Alexandar Jablanović, më 3 shkurt, anëtarët e Listës Srpska nuk po marrin pjesë në seancat e Kuvendit, apo në qeveri. Përfaqësuesit e tyre thanë se nuk do të kthehen deri në plotësimin e të gjitha kushteve sipas marrëveshjeve të koalicionit.⁵⁸

Ndërkohë, para krijimit të Asociacionit, liderët e Prishtinës duan që komponentët tjera të marrëveshjes të zbatohen së pari dhe të largohet "Parkut i Paqes" në lumin Ibër, si dhe të ketë funksionim normal të marrëdhënieve me komunat. Megjithatë, Beogradi dhe serbët e Kosovës e shohin këtë si një prioritet të menjëhershëm.

Në fund të muajit marsi 2015, përfaqësuesit kryesorë serbë nga e tërë Kosova mbajtën një takim jozyrtar konstituiv në Graçanicë. Pjesëmarrësit në takim nxorën dhjetë konkluzione për të ardhmen e përfaqësimit politik serb në Kosovë⁵⁹:

- Udhëheqësit gjithashtu kërkuan një regjistrim të popullsisë në zonat serbe, meqë serbët bojkotuan regjistrimin e fundit të popullsisë në Kosovë. Kjo do të mundësonte që ndarjet buxhetore të bëhen në baza reale dhe jo të parashikuara.
- Përfaqësuesit janë pajtuar që komuniteti serb duhet të përfaqësohet politikisht në të gjitha komunat, përfshirë edhe ato ku ata nuk janë shumicë.
- Mbrojtje e plotë për pronën e Kishës Ortodokse Serbe.
- Kthimi në Kosovë i të gjithë serbëve të zhvendosur.
- Vendimet ligjore që ndikojnë në komunitetin serb duhet të gëzojnë pëlqimin e plotë paraprak të përfaqësuesve të zgjedhur politikë serbë në Kosovë, theksohej në një pikë tjetër.
- Ndalim i privatizimeve të mëtejshme dhe hetim i keqbërjeve në procesin e privatizimit deri tani.
- Kërkesë për njohjen e licencave të Odës së Avokatëve të Serbisë



- Lirimi i menjëhershëm i njerëzve të quajtur "të burgosur politikë".
- Mbështetje e plotë për një "Asociacion të fortë të Komunave Serbe".

Kërkesat për regjistrim të popullsisë janë legjitime: askush nuk mund t'i shërbejë vërtet një popullsië për ekzistencën e të cilës nuk ka informata konkrete. Një census do të ndihmonte që të ndahen burimet dhe vendet e punës në mënyrë adekuate. Të dhënat e censusit do të ndihmojnë që të ndahen resurset dhe punët në mënyrë adekuate. Të dhënat e reja të censusit do të lehtësonin integrimin e serbëve të Kosovës përmes strukturave të sapoformuara komunale dhe do të rezultojnë në buxhetim më të saktë. Të tilla janë edhe kërkesat që serbëve të Kosovës tu jepen pozita në qeveri sipas ligjit. Megjithatë, që kjo të ndodhë, Kosova dhe Serbia duhet të zgjidhin bllokimin e njohjes së diplomave të njëra-tjetrës dhe të zgjidhin çështjen e zhvendosjes së Universitetit të Prishtinës në Mitrovicë.

Aktualisht, Asociacionit/Bashkësisë nuk i është dhënë autonomi më e madhe se ajo që parashihet në Planin e Ahtisaarit. Megjithatë, kjo jep kapacitet të gjerë për të mbikëqyrur arsimin dhe kujdesin shëndetësor, si dhe mirëqenien, zhvillimin ekonomik lokal, planifikimin urban dhe institucionet kulturore. Diskutimet rreth këtij organi duhet të fokusohen në atë që ky organ mund dhe nuk mund të bëjë, jo që politikanët serbë të ngrenë pritje të një autonomie të plotë. Deklarimet e politikanëve se ajo do të jetë OJQ pa dhëmbë gjithashtu nuk ndihmojnë.

Draft-statutet janë në qarkullim midis kryeqyteteve dhe Brukselit, por asnjëri nga ta nuk ka është vënë në dispozicion për publikun. Kjo gjithashtu duhet të ndodhë sa më shpejt.

Siguria

Deri vitin e kaluar, kanë ekzistuar dy sisteme policore në veri të Kosovës, Policia e Kosovës (PK) dhe të punësuarit e Ministrisë së Serbisë për Punë të Brendshme (MUP). Që nga maji i vitit 2014, integrimi i 285 punonjësve të MUP-it në Policinë e Kosovës është përfunduar⁶⁰. Kjo ka shtuar më shumë se dyfish numrin e zyrtarëve të PK-së në katër komunat me shumicë serbe të veriut të Kosovës, duke e çuar atë në 530.⁶¹

Megjithatë, 1,200 ish-punëtorë të MUP-it ishin në pension. Personeli administrativ nuk u inkorporua asnjëherë dhe 800 punonjës të tjerë që nuk ishin nga Kosova e veriut nuk u integruan dhe nuk kanë të drejtë për pensione. Këta punonjës administrativë kanë protestuar me besimin se fryma e marrëveshjes ishte që njerëzit të mos humbasin punën, apo të mbështeten financiarisht si rezultat i marrëveshjes.⁶²

Për më tepër, ekzistojnë disa shqetësime rreth procesit të verifikimit për integrimin e punonjësve të MUP-it në PK. Miodrag Lekiq, zyrtar i operacioneve në

57 Reklama e fushatës: "3 nëntor, votimi për Srpskan, 4 nëntor, ndërtimi i Srpskas."

58 Teksti i marrëveshjes së koalicionit, në gjuhën serbe është në dispozicion këtu: <http://www.zeri.info/aktuale/10331/ekskluzive-marveshja-pdk-ldk-lista-srpska-dokument/>

59 <http://www.balkaninsight.com/en/article/kosovo-serb-leaders-unify-for-community-s-future>

60 Kjo temë është mbuluar më gjerësisht në raportin e parë BIG DEAL nga nëntori 2014. Për më shumë informata të hollësishme, shih http://pasos.org/wp-content/uploads/2014/04/police_integration_nk_web.pdf

61 <http://www.balkaninsight.com/en/article/serb-police-adapt-to-new-bosses-in-kosovo>

62 Intervistë me një analist, Mitrovicë e Veriut, mars 2015.

PK për rajonin e veriut të Kosovës, i treti në komandën rajonale dhe vëllau i tij Milani, u arrestuan më 25 shkurt 2015 për t'u marrë në pyetje në lidhje me vrasjen e Enver Zymberit, anëtarit të Njësisë Speciale të Intervenimit në PK. Zymberi është vrarë më 26 korrik 2011 gjatë një operacioni të PK-së për të marrë nën kontroll kufirin verior të Kosovës. Arrestimi ishte pjesë e një hetimi të EULEX-it për vrasjen Zymberit. Lekiq ishte gjithashtu pjesë e Policisë së Kosovës për disa vite me radhë, më pas në 2014 edhe vëllai i tij Milan i është bashkangjitur këtij institucioni, duke ngritur dyshime në lidhje me procesin e riemërimit. Të dy ishin suspenduar nga pozitat e tyre të punës.

Arrestimi ngre pyetje lidhur me nivelin e verifikimit të bërë për secilin zyrtar, për shkak të afatit të shkurtër në dispozicion për integrim.

Trupat e Mbrojtjes Civile

Trupat e Mbrojtjes Civile (TMC), të njohur si "Civilna Zastita", ishin pjesë e forcave ushtarake të Jugosllavisë. Serbia në vitin 2009 miratoi ligjin i cili e rregullonte këtë përmes ligjit Serb për Situata Emergjente dhe u ngarkuan me detyrën e reagimit të parë në situata të jashtëzakonshme siç janë përmbytjet dhe tërmetet.⁶³ Njësitë individuale janë nën qeveritë komunale.

Prishtina për shumë kohë i ka konsideruar ata të jenë organ i paligjshëm paramilitar, ndërsa në veri të Kosovës pjesëtarët e TMC-së pretendojnë se roli i tyre është humanitar.⁶⁴

Bashkëbiseduesit nga Kosova, Serbia dhe vendet e BE-së thanë se për disa muaj ishte afër arrija e një marrëveshjeje për shpërbërjen e TMC-së. Negociatat kanë qenë në vazhdim e sipër që nga dhjetori 2013, ndonëse plani fillestar i zbatimit të marrëveshjes së 19 prillit 2013 parashihte përfshirjen e tyre në institucionet përkatëse të Kosovës nga ajo periudhë. Në vizitën e saj në Prishtinë, përfaqësuesja e lartë Mogherini njoftoi se palët kishin arritur një marrëveshje për përfshirjen e anëtarëve në institucionet e Kosovës.⁶⁵

Janë 751 punonjës të TMC-së në katër komuna. Marrëveshja e kohëve të fundit në dispozicion në faqen e internetit të Qeverisë së Kosovës, parasheh që Qeveria e Kosovës do të krijojë 483 pozita, të gjitha në veri. Sikurse me integrimin e policisë, të gjithë aplikantët duhet të nxjerrin dokumente identifikimi të Kosovës, nëse veçse nuk i kanë ato dhe të kalojnë nëpër një kontroll të sigurisë me EULEX-in. Nuk është e qartë se ku do të vendosen të gjithë këta njerëz. Qeveria e Kosovës do t'i vendosë 80 persona në Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave dhe 25 në Shërbimin Korrektues. Të tjerët do të marrin paga nga "fondi rezervë", ndërsa mund të presin deri në tre vjet për sistemim të përherëshëm në vend të punës.

Marrëveshja parashikon që integrimi do të përfundojë deri më 1 shtator



"Unë nuk pres që njerëzit të cilët deri tani kanë punuar për qeverinë e tyre të mos kenë më vend pune."...
"Ata kanë qenë gjithmonë atje për të siguruar që të gjithë të ndjehen të sigurt dhe do të vazhdojnë ta bëjnë të njëjtën punë në kuadër të sektorit për gjendje të jashtëzakonshme dhe të institucioneve të tjera në Kosovë dhe Metohi."

— DEJAN PAVICEVIQ, ZYRTAR NDËRLIDHËS I QEVERISË SË SERBISË NË PRISHTINË

2015. Për më tepër, marrëveshja përcakton që do të largohen tri pikat e vëzhgimit në rrugën ndërmjet Mitrovicës dhe Jarinjës deri më 20 prill 2015 dhe se pika e vëzhgimit në veri tek ura e lumit Ibër që ndan veriun dhe jugun e Mitrovicës do të jetë nën kontrollin e Policisë së Kosovës nga po ajo ditë.

Integrimi më i suksesshëm është ai që shpërndan ish-anëtarët e TMC-së të gjitha agjencitë dhe institucionet. Kjo do të nxisë një lidhje më të ngushtë me Prishtinën, në vend që t'i mbajë punonjësit të lidhur me komunat. Përveç Agjencisë së Menaxhimit të Emergjencave dhe Shërbimeve Korrektuese, agjencitë si Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Agjencia e Pylltarisë, Administrata Tatimore dhe Ministria e Kulturës, janë vende të mira për të përfshirë ish punonjës të TMC-së.

Sipas të gjeturave të hulumtimit të Qendrës për Politika të Sigurisë në Beograd, përfaqësuesit e qeverisë së Kosovës e shohin si të rëndësishëm integrimin e personelit të strukturave paralele serbe nëpër institucionet qendrore - si shenjë e integritetit të përgjithshëm të komunitetit serb në shoqërinë kosovare. Duke pasur përfaqësim të tillë në nivelin qendror, serbët e Kosovës do të mund t'i pranojnë më lehtë institucionet e Kosovës. Sipas zyrtarëve të Kosovës, njësitet e mbrojtjes civile vazhdojnë të mbesin nën juridiksionin ekskluziv të komunave, ndarja do të thellohet si dhe potenciali për konflikte në të ardhmen do të rriten.⁶⁶

Kosova me siguri do t'i shfrytëzojë mjetet nga Fondi Zhvillimor për Veriun, i cili aktualisht ka në zotërim 5 milionë euro të mbledhura nga dogana në pikat kufitare të veriut, si dhe nga "fondi rezervë", i cili nuk ka qenë aktiv deri më sot.

Dejan Paviceviq, zyrtar ndërlidhës i Qeverisë së Serbisë në Prishtinë, tha se anëtarëve të Civilna Zastita-s do t'u garantohet punësimi i vazhdueshëm.

"Unë nuk pres që njerëzit të cilët deri tani kanë punuar për qeverinë e tyre të mos kenë më vend pune", tha Paviceviq në një intervistë me gazetën e Beogradit "Vecernje Novosti".

"Ata kanë qenë gjithmonë atje për të siguruar që të gjithë të ndjehen të sigurt dhe do të vazhdojnë ta bëjnë të njëjtën punë në kuadër të sektorit për gjendje të jashtëzakonshme dhe të institucioneve të tjera në Kosovë dhe Metohi", tha ai.

Shpërbërja e Civilna Zastita-s është dashur të përfundojë deri më 1 shtator, por buxheti të Kosovës i mungon një linjë për njësitë e mbrojtjes civile për vitin fiskal 2015 dhe zyrtarët kanë qenë të paqartë në lidhje me burimet e mundshme të financimit.

Serbia do të duhet ta ndryshojë Ligjin për Emergjencat për të cekur se nuk ka njësi të specializuara për raste emergjente në Kosovë. Ajo që duhet të bëhet është të ndërpritet financimi i këtyre organeve, ku preferohet të bëhet pasi të jetë miratuar një plan për pensionimin e parakohshëm të punonjësve ose transferimin e tyre në një vend të veçantë.

63 2009 Ligji për Sitiatat Emergjente - http://www.paragraf.rs/propisi/zakon_o_vanrednim_situacijama.html

Përkthim jozyrtar në gjuhën angleze - <http://www.seesac.org/res/files/failovi/547.pdf>

64 Intervista me pjesëtarë të TMC në Leposaviq, shtator 2014.

65 Teksti i plotë i marrëveshjes: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Agreement_on_CP_-_initialed_by_Kosovo_260315.pdf

66 Për më shumë informata, shih Bjelos, Maja dhe Stakic, Isidora, "E ardhmja e mbrojtjes civile në Veri të Kosovës," Qendra e Beogradit për Studime të Sigurisë, prill 2015.

Gjyqësori

“Jam i shokuar dhe i zemëruar që nuk është paraparë as edhe një ulëse e vetme për pakicat joserbe në marrëveshje. Ne do ta luftojmë këtë vendim.” – Qerim Bajrami, deputet i Kuvendit të Kosovës.

Në orët e hershme të mëngjesit të 10 shkurtit 2015, kryeministrat e Kosovës dhe Serbisë arritën marrëveshje për një çështje kyçe që kishte mbetur e pazgjidhur për gati dy vjet pas marrëveshjes së 19 prillit 2013-përbërjen e gjyqësorit të unifikuar për të gjithë territorin e Kosovës. Takimi së pari është mbikëqyrur nga përfaqësuesja e lartë e re e BE-së, Mogherini dhe së pari nga kryeministrat Vuçiq dhe Mustafa. Kjo ishte marrëveshja e parë e nivelit të lartë që arrihet pas një stagnimi prej gati 10 muajsh.

Për më shumë se gjashtë muaj para kësaj, nuk ka pasur funksionim të gjykatave penale në katër komunat veriore të Kosovës, duke krijuar një vakum të drejtësisë që ende nuk është mbushur. Status quo-ja nuk është parë si vakum nga shumë serbë të Kosovës, të cilët besojnë se komuniteti i tyre është i vetërregulluar⁶⁷, por në fakt vetëm EULEX-i është në vend për t'u marrë me aktivitetet kriminale, ndonëse misioni i tij është vendosur që të përfundojë në qershor të vitit 2016.

Marrëveshja ndan detyrat e një gjykate themelore në zyrat në veri dhe në jug dhe krijon sisteme të kuotave etnike për gjykatësit dhe të punësuarit, pa ndonjë dispozitë për joserbët dhe joshqiptarët që është diskriminuese dhe me gjasë kundërkushtetuese. Siç është bërë zakon, marrëveshja nuk është publikuar zyrtarisht, por ka rrjedhur, ndonëse mungonte faqja e dytë. Ajo u është dhënë deputetëve pothuajse një muaj më vonë, më 6 mars.

Parimet bazë të marrëveshjes janë si në vijim:


Do të jetë një gjykatë themelore dhe një zyrë themelore e prokurorisë për rajonin e Mitrovicës që përfshin katër komunat veriore dhe komunat me shumicë dërrmuese shqiptare dhe më të populluara të Skenderajt dhe Vushtrrisë. Gjykata e vetme themelore do t'i ketë dy ndërtesa (në veri dhe jug të Mitrovicës) dhe katër degë të gjykatës: Zubin Potok, Leposaviq, Skenderaj dhe Vushtrri.

Objekti i gjykatës në Mitrovicën e Jugut do të ketë Departamentin për të Miturit për të gjithë rajonin. Ajo do të gjykojë çështjet civile, paditë jokontestimore dhe kundërvajtjet për veriun dhe jugun e Mitrovicës dhe Zveçanin.

Kryetari i gjykatës do të jetë një serb i Kosovës nga veriu i Kosovës. Kryeprokurori do të jetë shqiptar i Kosovës, me zyrë në Zyrën Administrative të Mitrovicës Veriore në Lagjen e Boshnjakëve.

Caktimi i lëndëve në prokurori bazohet në ekspertizë, specializim, në formimin personal dhe njohjen e zonës lokale. (Kjo duket të jetë vendosur kështu për të siguruar të dyja palët se lëndët e tyre më gjasë do të ndiqen nga anëtarë të të njëjtit grup etnik-kombëtar.)

Gjykata themelore do t'i ketë 14 gjyqtarë shqiptarë dhe 10 gjyqtarë serbë në



ndërtesën e vendosur në Mitrovicën Jugore dhe 14 gjyqtarë serbë dhe 10 shqiptarë në zyrat e Mitrovicës së Veriut.

Zyra e prokurorisë do të ketë 9 serbë dhe 9 shqiptarë me 24 punonjës mbështetës për secilën.

Do të jenë 79 serbë dhe 79 shqiptarë si staf mbështetës, megjithëse degët në Zubin Potok dhe Leposaviq do të kenë të dyja nga shtatë zyrtarë serbë.

Gjykata në veri të Mitrovicës do të ketë një Divizion të Apelit me pesë gjyqtarë serbë të Kosovës dhe 2 gjyqtarë shqiptarë të Kosovës. Ajo gjithashtu do të akomodojë Divizionin e Krimeve të Rënda për të gjithë rajonin që do të përbëhet nga katër gjyqtarë serbë të Kosovës dhe katër gjyqtarë shqiptarë të Kosovës. Gjithashtu ai do të gjykojë në veprat penale për Mitrovicën e Veriut, atë të Jugut dhe Zveçanin. Një serb i Kosovës do të emërohet nënkryetar i Gjykatës së Apelit në Prishtinë.

Marrëveshja do të detyrojë Kosovën që të punësojë gjyqtarë dhe prokurorë me përvojë, të besuar dhe të talentuar të serbëve të Kosovës në mënyrë që ta kthejnë besimin në gjyqësorin. Sistemi veçse ka mungesë të stafit, me 18.3 gjyqtarë aktivë për 100 mijë njerëz, sipas Këshillit Gjyqësor të Kosovës⁶⁸. Ky numër është më i lartë se viteve të fundit, por mjaft më i ulët se në vendet e tjera të rajonit.⁶⁹

Një punonjës i gjyqësorit serb në veri të Mitrovicës ka shprehur shqetësim në lidhje me nevojën që shqiptarët të sillen në gjykatën në Mitrovicë të Veriut dhe serbët të procedohen në Jug.

“Viteve të fundit marrëdhëniet mes serbëve dhe shqiptarëve në Mitrovicë janë përkeqësuar, nuk janë përmirësuar”, tha punonjësi. “Dhe tani të dyja palët e kanë dhënë besimin e tyre në një sistem të drejtësisë i cili do të udhëhiqet nga gjyqtarët dhe prokurorët të cilët nuk janë nga komunitetet e tyre.”⁷⁰

Nuk ka pasur informata në lidhje me afatet për zbatim apo planin e zbatimit, të cilat zakonisht paraqesin më shumë detaje dhe afatet kyçe për realizimin e parimeve të marrëveshjes. Një përfaqësues i Qeverisë së Kosovës tha për Big Deal se nuk ka “plan të zbatimit; plani i vetëm është që të zbatohet marrëveshja.”

Në fund të marsit, Kosova shpalli vendet e lira për punëtorët joshqiptarë në gjyqësor që tregon se zbatimi ka filluar.

Kjo Marrëveshje, sikurse marrëveshja për policinë (ku komandanti rajonal i policisë duhet të jetë serb) ka ngjallur zemërim tek komunitetet joserbe në Kosovë, meqë ajo nuk parashikon në mënyrë të qartë pjesëmarrjen e tyre në gjyqësor. Përfaqësues të komuniteteve boshnjake, gorane, turke, ashkalinje, rome dhe egjiptiane kanë ngritur zërin e tyre të frustrimit dhe qëllimin e tyre për

68 Këshilli Gjyqësor i Kosovës, “Gjashtëmujori i parë 2014 Statistikat e Gjykatave,” gusht 2014. http://www.kgjk-ks.org/repository/docs/STATISTICS_REPORT_ON_THE_WORK_OF_THE_COURTS_Mid-year-2011_638768.pdf

69 Shih Grupin Ndërkombëtar të Krizave, “Sundimi i Ligjit në Kosovën e Pavarur,” 19 maj 2010. Gjatë kohës së hartimit të raportit, Bosnja dhe Hercegovina kishte 22.1 gjyqtarë për 100,000 banorë gjersa Kroacia kishte 40.1 dhe Mali i Zi 51. <http://www.crisisgroup.org/~media/Files/europe/balkans/kosovo/204%20The%20rule%20of%20Law%20in%20Independent%20Kosovo.pdf>

70 Intervistë, Punonjës serb i Kosovës në gjykatë serbe në veri të Mitrovicës

67 Intervistë në Mitrovicë të Veriut me një punonjës të gjykatës, mars 2015.

ta kundërshtuar këtë vendim para Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

“Jam i shokuar dhe i zemëruar që nuk është paraparë as edhe një ulëse e vetme për pakicat joserbe në marrëveshje”, i tha deputeti boshnjak ministres Tahiri, kur ajo iu adresua Komisionit Parlamentar për Punë të Jashtme. Ai theksoi se planifikon ta sjellë marrëveshjen para Gjykatës Kushtetuese.

Megjithatë, nuk pritet që gjykata do të shpallë këtë lëndë si të pranueshme. Marrëveshja e 19 prillit u sfidua para Gjykatës Kushtetuese të Kosovës nga deputetët e “Vetëvendosjes”, ndër të tjera, për shkak të sistemit të sigurimit të vendeve të punës në bazë të përkatësisë etnike për zyrtarët e gjyqësorit dhe policisë. Gjykata nuk pranoi ta shqyrtojë rastin, duke thënë se marrëveshjet ndërkombëtare nuk janë subjekt i rishikimit të gjyqësorit kushtetues.

Neni 53 i Kushtetutës së Kosovës thekson se: “Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.(GjEDNj).” Në vitin 2009, në vendimin e saj “ Sejdiç- Finci”, GjEDNj vendosi që dispozita e Kushtetutës së Bosnjë dhe Hercegovinës, e cila parashikon kryesim treanëtarësh të përbërë nga një serb, një kroat dhe një boshnjak cenon standardet evropiane të të drejtave të njeriut. Kjo përbën precedent në praktikën gjyqësore të Konventës Evropiane që mund t'i cenojë në të ardhmen marrëveshjet e rëna dakord midis Beogradit dhe Prishtinës.

Dokumentet: diplomat, regjistri civil, kadastra

“Që nga viti 2010 kam provuar të siguroj që diploma ime nga fakulteti i mjekësisë në Beograd të njihet në Kosovë. Pa këtë, nuk kam të drejtë të punoj në klinika publike dhe kjo gjë më ka dëmtuar profesionalisht dhe personalisht. Unë jam vetëm një viktimë e lojërave politike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, dhe ndjej që unë, si qytetar, nuk ekzistoj fare.”

– Edis Jonuzi, terapeut fizik, Prizren

Diplomat

Njohja reciproke e diplomave është një çështje që prek jetën e shumë të rinjve nga Kosova dhe Serbia. Shqiptarët në Serbi ndonjëherë vendosin të studiojnë në Kosovë në mënyrë që të mund të mësojnë në gjuhën e tyre amtare. Serbët në Kosovë kanë nevojë për diploma universitare për të marrë punë të nivelit më të lartë, veçanërisht në qeveri, ku në shumicën e institucioneve serbët janë të nënpërfaqësuar⁷¹. Përderisa mungesa e diplomave të njohura mund të mos jetë e vetmja arsye për këtë, ajo sigurisht është komponent kyç.


Shqiptarët që jetojnë në Serbi që duan të gjejnë punë në sektorin publik,

⁷¹ Sipas një studimi të vitit 2013 të kontraktuar nga Qeveria e Kosovës, pak ministri apo institucione kanë pasur përfaqësim të pakicave në nivel të kërkuar prej 10% sipas ligjit. Ministria e Financave, Drejtësisë, dhe ajo e Integritimit Evropian kanë më pak se 2% përfaqësim të pakicave. Situata është e ngjashme në administratën tatimore (3%), thesar (1,5%) dhe dogana (1,4%). Policia e Kosovës ka më shumë se 10 % të kërkuar me ligj. Për më shumë informata shih “Vlerësimi mbi punësimin e anëtarëve të komuniteteve joshumicë në Shërbimin Civil të Kosovës dhe Ndërmarrjet Publike”, korrik 2013, nga Novartis Consulting. http://www.novusconsult.net/pdf/FINAL_PRESENTATION_07_2013.pdf



“Jam i shokuar dhe i zemëruar që nuk është paraparë as edhe një ulëse e vetme për pakicat joserbe në marrëveshje”

— DEPUTET
BOSHNJAK



gjithashtu përballen me balancimin e dëshirave të tyre për të studiuar në gjuhën e tyre amtare dhe për të pasur mundësinë që të punësohen në të ardhmen.

Më 21 nëntor 2011, të dyja palët kanë rënë dakord që “të kërkojnë nga Asociacioni i Universiteteve Evropiane (EUA) që të vërtetojë diplomat universitare të lëshuara nga universitetet e të dyja palëve për t’u përdorur nga njëra-tjetra në lidhje me arsimin e mëtejshëm dhe/ose punësimin publik”. EUA është pikërisht siç tingëllon, një organ që përfaqëson më shumë se 800 universitete nga 47 vende në Evropë, e angazhuar për shkëmbim dhe bashkëpunim⁷².

Një OJQ holandeze, SPARK-u, është ngarkuar me mbikëqyrjen e procesit si palë e tretë, duke pranuar aplikime nga Kosova dhe Serbia dhe duke i përcjellë ato tek EUA-ja. Megjithatë, kontrata dyvjeçare me SPARK-un skadoi në korrik të vitit 2014 dhe ajo nuk është rinovuar. Sipas përfaqësuesve të SPARK-ut, kjo është bërë meqë të dyja palët duhet të zotohen sërish për pranimin e vërtetë të diplomave.

Zbatimi filloi në shkurt të vitit 2012 dhe deri në fund të gushtit të vitit 2014 janë miratuar 362 aplikime nga Kosova dhe 13 nga Serbia dhe janë lëshuar certifikatat e njohjes së të. Kjo është nga gjithsej 408 aplikantë nga Kosova dhe 25 nga Serbia.

Megjithatë, Serbia ka njohur vetëm pesë nga më shumë se treqind diploma të Kosovës që ishin pranuar nga Asociacioni i Universiteteve Evropiane (EUA), pas një procesi shtesë të nostrifikimit.⁷³

Besa Ismaili, një shqiptare etnike nga Medvegja e Serbisë, ka kryer studimet në Kolegjin Fama në Prishtinë për të marrë diplomë Bachelor në Kriminologji në gjuhën e saj amtare. Ajo thotë se Ministria e Arsimit në Serbi i tha asaj që të bëjë pyetje rreth nostrifikimit, por ministria e dërgoi atë në Universitetin e Nishit. Megjithatë, ai universitet nuk ka fakultet të Kriminologjisë kështu ata e kthyen atë tek Ministria e Arsimit.

Ismajli, 28 vjeçe, tha se ajo ishte në grupin e parë të njerëzve që aplikonin përmes SPARK-ut, por asgjë nuk kishte ndodhur.

“Nuk jam e sigurt nëse ky proces për njohjen e diplomave ishte diçka serioze, apo diçka për ta larguar vëmendjen nga ky problem,” tha ajo për BIG DEAL.⁷⁴

Kosova, gjithashtu, ka krijuar pengesa për njohjen e diplomave serbe dhe nuk e njej asnjëherë. Edita Tahiri ka thënë se kjo është për shkak se Serbia nuk do të duhej të kishte kërkuar proces shtesë të nostrifikimit, që është ajo që çdo shtetasi nga çdo vend duhet t’i njihet zyrtarisht diploma.

“Është dashur të kemi marrëveshje për shkak se Serbia nuk ka pranuar nostrifikimin e diplomave tona ashtu si do të bënte ndonjë vend tjetër,” tha ajo për BIG DEAL. “Nëse Serbia kërkon nostrifikim është shkelje e marrëveshjes sonë”.

⁷²<http://www.eua.be/Home.aspx>

⁷³ Intervistë me punonjësin e SPARK, Beograd, mars 2015.

⁷⁴ Intervistë, mars 2015.

Bozhidar Vasiq, i cili u diplomua nga Fakulteti Juridik i Novi Sadit në Beograd në vitin 2008, u kthye në Kosovë me shpresë se do të gjejë punë. Sapo u publikua marrëveshja për njohjen reciproke, ai mblodhi dokumentet e nevojshme dhe i dërgoi ato në zyrat e SPARK-ut në Beograd, por pa ndonjë rezultat. Për shkak që nuk arriti të sigurojë njohje të diplomës së tij, ai aktualisht punon si sekretar shkolle në Gjilan, në kuadër të administratës serbe.

“Unë jetoj në Kosovë dhe është logjikë e thjeshtë që unë të dua të marr pjesë në sistemin juridik këtu,” tha ai për BIG DEAL. “Unë jam një person që ka mbaruar fakultetin në Novi Sad dhe dua të integrohem, por aktualisht në mënyrën se si i kanë bërë marrëveshjet, kjo është e pamundur. Të gjitha këto marrëveshje, por asgjë nuk ka dalë nga to. Andaj dua të pyes, çfarë kanë arritur ato?”

Edis Jonuzi nga Prizreni, ka studiuar për fizioterapi në fakultetin e mjekësisë në Beograd në vitin 2010 në mënyrë që të mund të shkollohet në gjuhën e tij amtare. Ai ishte pranuar përkohësisht për ta kryer punën praktike në spitalin e Prizrenit dhe pastaj në Prishtinë. Por kur erdhi koha të gjejë një punë me orar të plotë, punëdhënësit e tij i thanë se me kënaqësi do t'i ofrojnë atij një vend pune nëse arrin ta sigurojë njohjen e diplomës. Ai tha për BIG DEAL se nga viti 2010 ka mbajtur takime me ministrat e shëndetësisë dhe arsimit të Kosovës dhe pastaj me zëvendëskryeminstren Edita Tahiri. Ai përfundoi procesin e certifikimit përmes SPARK-ut. Është dashur që Avokati i Popullit, Sami Kurteshi të ndërmerretë në emër të tij. Por ende nuk po arrin të sigurojë një vend pune në një institucion publik.

“Që nga viti 2010, kam bërë përpjekje që diploma ime e fakultetit të mjekësisë në Beograd të njihet në Kosovë,” tha ai për BIG DEAL. “Pa të, nuk kam të drejtë të punoj në klinika publike dhe kjo më ka shkaktuar dëme profesionale dhe personale. Unë jam vetëm një viktimë e lojërave politike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë”, tha Jonuzi.

Qeveria e Kosovës nuk dëshiron ta diskutojë problemin e zhvendosjes së Universitetit të Prishtinës në Mitrovicë, fakultetin e vetëm në gjuhën serbe në Kosovë. Ai ka rreth 12.000 studentë nga grupet e tjera serbe dhe sllavo-folëse.


“Kjo nuk ishte pjesë e dialogut dhe tani nuk është pjesë e diskutimit”, tha një zyrtar i Qeverisë së Kosovës për BIG DEAL⁷⁵. Ekziston një propozim pranë Zyrës së Kryeministrit si rezultat i konsultimeve dhe bashkëpunimit kreativ me OJQ-të e Kosovës, por ai ka ende nuk është diskutuar apo prezantuar zyrtarisht.

As pranimi i diplomave për qëllimin e studimeve të doktoratës nuk është hapur si temë, që ka kufizuar mundësinë e studentëve për të studiuar në nivel rajonal.

Kadastra

“Nëse ligji për Agjencinë e Krahasimit dhe Verifikimit të Pronave të Kosovës miratohet, ne do të ndërprejmë menjëherë kopjimin e dokumenteve” – Zyrtar

⁷⁵ Intervistë, zyrtar i qeverisë së Kosovës, mars 2015.



“Që nga viti 2010, kam bërë përpjekje që diploma ime e fakultetit të mjekësisë në Beograd të njihet në Kosovë.”

—EDIS JONUZI

serb.

Shumica e dokumenteve kadastrale të Kosovës janë marrë nga Serbia gjatë luftës dhe menjëherë pas saj. Që atëherë Kosova është përballur me vështirësi, me konteste pronësore si pasojë e mungesës së një kadastrë përfundimtare. Kosova dhe Serbia arritën marrëveshje më 2 shtator 2011 dhe u pajtuan në dhjetor të të njëjtit vit që të skanohen të gjitha dokumentet kadastrale para vitit 1999 dhe ato skenime të dorëzohen në Kosovë përmes EUSR-së. Një agjenci teknike, Agjencia Kosovare për Krahasimin dhe Verifikimin e Pronave (AKKVP) pastaj do t'i krahasojë dokumentet e skanuara me kadastrën e rikonstruktuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës.

Më 5 shkurt 2015, qeveria miratoi projektligjin për AKKVP-në⁷⁶ dhe dërgoi atë në Kuvend të Kosovës për lexim të parë. Më 24 mars 2015, Komisioni Legjislativ i Kuvendit të Kosovës miratoi një vendim për t'i rekomanduar seancës plenare që ta votojë projektligjin për Agjencinë KKVP në leximin e parë.⁷⁷

Procesi filloi në janar të vitit 2012 dhe fillimisht ishte parashikuar të përfundojë deri në fund të vitit 2014. Kjo nuk ka ndodhur, por ka pasur progres të konsiderueshëm që nga raporti i fundit: një milion e gjysmë faqe të dokumenteve janë skanuar në Beograd deri në fund të shkurtit 2015. Kjo do të thotë se nga 1,300 zona kadastrale ekzistuese në Kosovë, digjitalizimi i një të tretës së tyre ka mbaruar.

Me ritmin aktual dhe vlerësimet aktuale nga EUSR-ja në Kosovë, të gjitha dokumentet do të skanohen deri në fund të vitit 2015. Ato pastaj do të indeksohen dhe do të dorëzohen tek EUSR-ja. Deri në atë kohë agjencia e re, AKKVP, duhet të jetë e themeluar dhe funksionale, me kusht që ligji të jetë miratuar nga Parlamenti në gjysmën e parë të 2015-ës.

Megjithatë, ende mund të ketë komplikime në këtë proces.

Më 30 janar të vitit 2014 Gjykata Kushtetuese e Serbisë vendosi se “Dekreti për modalitetet e veçanta të procesimit të të dhënave të përfshira në regjistrat e kadastrës së tokave për Krahinën Autonome të Kosovës dhe Metohisë” nuk është në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet.

Publikimi i vendimit në Gazetën Zyrtare është shtyrë për gjashtë muaj, deri më 1 gusht, në mënyrë që “të jepet kohë për autoritetin kompetent për rregullimin e çështjeve... në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin”.⁷⁸

Gjykata arriti në përfundimin se “Qeveria si organ ekzekutiv me anë të miratimit të kësaj rregulloreje shkoi përtej juridiksionit të saj të përcaktuar me kushtetutë.”⁷⁹ Zyra e Serbisë për Kosovë dhe Metohi ka përgatitur një draft të ri të dekretit, i cili u miratua më 22 gusht 2014. Megjithatë, vendimi i Gjykatës Kushtetuese pothuajse e pamundëson që një dekret i ri qeveritar do të mund ta zgjidhë problemin. Reforma kushtetuese mund të jetë e vetmja mënyrë që ligjërisht të transferohen dokumentet kadastrale në Kosovë përmes EUSR-së.

⁷⁶<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/04-L-167.pdf>

⁷⁷ Para dy viteve, ai nuk u miratua në kuvend. Vetëvendosje e kundërshtoi projektligjin fillestar për shkak se AKKVP do të kishte anëtarë ndërkombëtarë, ndërsa partia ishte kundër saj.

⁷⁸Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Serbisë në rastin IUo-870/2012.

⁷⁹ Po aty.

Përveç kësaj, një zyrtar i qeverisë serbe tha për BIG DEAL se ata janë kundër themelimit të AKKVP-së për shkak të qëllimit të saj që t'i krahasojë dokumentet e vjetra kadastrale me një regjistër të ri, për të krijuar një kadastrë të azhurnuar.

“Ata planifikojnë t'i legalizojnë të gjitha këmbimet e paligjshme të pronave dhe vjedhjet që kanë ndodhur në ditët e menjëhershme të pasluftës,” tha zyrtari serb për BIG DEAL. “Nëse ligji për AKKVP-në miratohet ne do të ndërprejmë kopjim e dokumenteve menjëherë”.⁸⁰

Por një zyrtar i lartë i Kosovës tha të kundërtën për ekipet e BIG DEAL:

“Ne na duhen dokumentet origjinale për të bërë krahasim me ato të tanishme pikërisht sepse ne e dimë se ka pasur gjëra të paligjshme që kanë ndodhur me pronat pas luftës, por për shkak të mungesës së dokumenteve nuk kemi mundur t'i zgjidhim dhe bëjmë të njohur deri më tani pronarët e vërtetë”, tha zyrtari. “Këto dokumente do t'i ndihmojnë gjykatat që të përcaktojnë se çfarë ka ndodhur me atë pronë. Mos harroni, mungesa e qartësisë lidhur me pronarët e pronave është një nga pengesat kryesore për investime në Kosovë, kështu që ne po presim t'i marrim ato dokumente origjinale dhe që gjykatat t'i përdorin ato dhe të marrin vendime në bazë të këtyre dokumenteve origjinale.”

Regjistri civil

Para luftës dhe gjatë saj, regjistrat civilë të Kosovës që përfshinin informata për lindjet, vdekjet, martesat për qytetarët e Kosovës të lindur në mes të periudhës 1850 dhe 1999, janë shkatërruar, djegur ose zhvendosur në Serbi. Është arritur marrëveshja më 2 korrik 2011. Kthimi i 12.391 regjistrave të certifikuar të gjendjes civile përfundoi në mars të vitit 2014. Tani Kosova po zbaton një projekt të financuar nga BE-ja të digjitalizimit të këtyre kopjeve.

Kosova dhe bota

“Kam folur me kryeministrin serb Vuçiq lidhur me bashkëpunimin ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Kemi vendosur që situatat specifike apo zhvillimet e papritura të zgjidhen përmes kontaktit të drejtpërdrejtë”. kryeministri i Kosovës Isa Mustafa.

Marrëveshjet Kosovë-Serbi kanë hapur dyert për bashkëveprim më të gjerë të Kosovës me rajonin dhe me botën. Së pari dhe më së rëndësishmi, Kosova dhe Serbia kanë “zyrtarë të ndërlidhjes” në Beograd dhe Prishtinë, të dy të vendosur në zyrat përkatëse të BE-së. Ata monitorojnë dhe angazhohen në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me normalizimin. Që nga 1 dhjetori 2014 ata gjithashtu organizojnë dhe menaxhojnë të gjitha vizitat zyrtare, duke përfshirë koordinimin dhe sigurinë që më parë trajtoheshin nga zyrat e BE-së⁸¹. Palët janë pajtuar gjithashtu që të punësojnë një anëtar shtesë të stafit në të dyja zyrat. Kjo nuk është arritje e vogël duke marrë parasysh çështjet në dukje të vogla për të cilat

“Ata planifikojnë t'i legalizojnë të gjitha këmbimet e paligjshme të pronave dhe vjedhjet që kanë ndodhur në ditët e menjëhershme të pasluftës.”... “Nëse ligji për AKKVP-në miratohet ne do të ndërprejmë kopjim e dokumenteve menjëherë.”

— ZYRTAR SERB

“Kam folur me kryeministrin serb Vuçiq për bashkëpunimin e ardhshëm ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ne vendosëm që situatat specifike, ose zhvillimet e papritura të zgjidhen përmes kontaktit të drejtpërdrejtë.”

—ISA MUSTAFA,
KRYEMINISTËR I
KOSOVËS

janë zënë zyrat ndërlidhëse: çfarë mund të shkruhet në kartëvizita dhe çfarë jo, si të duket mbishkrimi zyrtar në shkresa, kush duhet t'i përcjellë e-mailat dhe çështja e pazgjidhur ku të dyja zyrat veprojnë pa vula..

Për sa i përket pjesëmarrjes në organet rajonale, fluksi i emigrantëve nga Kosova në Serbi në muajt e fundit ka theksuar rëndësinë për bashkëpunim më intensiv. Më 26 mars, drejtori i Policisë së Serbisë Milorad Veljović priti homologun e tij kosovar Shpend Maxhunin në Beograd për takimin e parë, të mbajtur nën patronazhin e EULEX-it. Takimi ishte i pari i këtij lloji. Megjithatë, ky takim ndodhi 5 muaj pas raportimit të gjerë në media vendore dhe ndërkombëtare të largimit të qindra shqiptarëve të Kosovës çdo natë nga stacioni i autobusëve në Prishtinë drejt Beogradit, Suboticës dhe pastaj në mënyrë të paligjshme për në Hungari. Një hetim i BIRN-it zbuloi se bandat kriminale shqiptare dhe serbe ishin të përfshira në këtë kontrabandim me njerëz. Është e qartë që është për të ardhur keq se takimi në mes të Maxhunit dhe Veljovićit erdhi disa muaj pasi që emigrantët nga Kosova kalonin përmes Serbisë për në Hungari dhe pastaj drejt Evropës Perëndimore. Ndonëse ishte vonë, ky takim është për t'u lavdëruar.

Ky takim erdhi disa ditë para lajmit që kryeministrat Vuçiq dhe Mustafa kishin pasur komunikim të drejtpërdrejtë me njëri-tjetrin.

“Kam folur me kryeministrin serb Vuçiq për bashkëpunimin e ardhshëm ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ne vendosëm që situatat specifike, ose zhvillimet e papritura të zgjidhen përmes kontaktit të drejtpërdrejtë”, tha Mustafa pas diskutimit. “Jemi pajtuar që kur të hasim në çështje që kanë nevojë për veprime të shpejta në terren, ne mund të komunikojnë drejtpërdrejt – në mënyrë që të gjejmë zgjidhje të shpejta dhe të mos presim për takimet në Bruksel”.⁸²

Një tjetër takim rajonal, Ballkani Perëndimor-Gjashtë, është mbajtur në Prishtinë më 25 mars të vitit 2015. Ministri i jashtëm serb Ivica Dačić mori pjesë dhe u konsultua me homologun e tij të Kosovës Hashim Thaçi, në prapavijat e takimit.

Në organet rajonale, Kosova gjithashtu ka shënuar progres. Kosova u bë anëtare e plotë e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC), Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP), Shkollës Rajonale të Administratës Publike (RESPA) në vitin 2013 apo në fillim të vitit 2014. Në tetor të vitit 2014, Kosova u anëtarësua me të drejta të plota në Qendrën për Bashkëpunim të Sigurisë (RACVIAC), ndonëse qeveria është ankuar se Kuvendi i Kosovës nuk është ftuar të marrë pjesë në asnjë aktivitet.⁸³

Në raportin e saj të tretë për “gjendjen aktuale”, ministrja Tahiri gjithashtu është ankuar se “Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk është përfshirë, apo madje as ftuar që të marrë pjesë në aktivitetet e Forumit Parlamentar në Cetinje, Nismën e Dimensionit Parlamentar Adriatik-Jonian, Asambleenë Parlamentare të Unionit për Mesdheun, Unionin Ndërparlamentar-IPU, Organizatën për Siguri

⁸⁰ Intervistë me zyrtar qeveritar serb në Mitrovicë të Veriut, mars 2015.

⁸¹ Kjo përfshin vizitën e profilin të lartë të Kryeministrit Vuçiq në Kosovë në janar 2015.

⁸² <http://www.balkaninsight.com/en/article/kosovo-pm-we-have-established-a-direct-line-to-belgrade>
⁸³ Tahiri, 2015, faqe 21.

dhe Bashkëpunim në Evropë-OSBE⁸⁴, Takimin Rajonal të Komiteteve të Punëve të Jashtme dhe Fondacionin Westminster për Demokraci.⁸⁵

Së fundi, ngjarjet e gjashtë muajve të fundit nxjerrin në pah nevojën që Kosova të anëtarësohet në organizatat ndërkombëtare të bashkëpunimit policor – ONBP, më së rëndësishmi në Interpol dhe Europol. Aktualisht, UNMIK-u menaxhon marrëdhëniet me Interpolin, dhe EULEX-i mbikëqyr kontaktet me Europolin. Me reduktimin e stafit të EULEX-it kjo nevojë është edhe më e madhe.

Anëtarësimi i Kosovës do të jetë në të mirë të sigurisë rajonale dhe Serbia nuk duhet ta bllokojë këtë pranim. Për më tepër, Këshilli Evropian duhet të propozojë që meqë Kosova do të nënshkruajë së shpejti Marrëveshjen e Stabilitimit-Asociimit (SAA), ajo të bëhet anëtare e Europolit.⁸⁶

Telekomi

“Në BE dhe shtetet fqinje, ngarkesat për roaming janë të rregulluara. Meqë Kosova nuk është në BE dhe nuk ka kod shtetëror, ne nuk kemi kontroll mbi tarifën për roaming. Ne po paguajmë mesatarisht tetë herë më shumë se fqinjët tanë apo shtetet e BE-së për thirrjet në roaming dhe rreth 100 herë më shumë për internetin në roaming”- Bardha Ahmeti, OJQ “LENS”.

Për sa i përket çështjes së telekomit, nuk është shënuar asnjë përparim që prej raportit të parë BIG DEAL në nëntor 2014, ndonëse marrëveshja fillestare parashikonte që kodi i ri shtetëror i Kosovës do të jetë i gatshëm qysh nga 1 janari 2015.

Më 8 shtator 2013, palët ranë dakord që BE-ja dhe Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit (ITU) do t'i ndajë Kosovës kodin e saj treshifror të telefonisë dhe do t'i largojnë tri përdorimet e Kosovës (për linjën tokësore të Serbisë dhe Sllovenisë dhe të Sllovenisë e Monakos për mobil) dhe do t'i lehtësojnë marrëveshjet për interkoneksion dhe roaming midis operatorëve të të dyja palëve⁸⁷. Kjo është e rëndësishme, sepse aktualisht përdoruesit e telefonave mobilë në Kosovë të cilët kanë shërbime të “Valës” nuk mund t'i përdorin telefonat e tyre në Serbi. Si dhe disa kompani serbe nuk kanë roaming në Kosovë. Operatori kombëtar serb Telekom Srbije funksionon vetëm në territoret me shumicë serbe të Kosovës, përndryshe nuk ka asnjë sinjal.

Një degë e një kompanie serbe, e regjistruar në Kosovë, do të marrë licencë për operimin e telefonisë fikse. Marrëveshja parasheh që kjo kompani e re do të marrë autorizim të përkohshëm për të ofruar shërbime të telefonisë mobile si dhe deri në një tender /ankand të ri që do të çojë në një licencë të plotë të pakufizuar mobile⁸⁸.

84 Serbia mori përsipër kryesimin në rotacion të OSBE-së më 1 janar 2015

85 Tahiri, 2015, f 21.

86 Për më tepër, nevoja që Kosova t'u bashkohet Organizatave Ndërkombëtare të Bashkëpunimit-it Policor, shih raportin vijues, të hartuar nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike dhe BIRN, publikuar në mars 2015: <http://legalpoliticalstudies.org/wp-content/uploads/2015/03/raporti-anqisht-final-final.pdf>

87 Shih marrëveshjen këtu: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Arrangements_regarding_Telecommunications_September_8_2013.pdf

88 Shih marrëveshjen e plotë këtu: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Arrangements_regarding_Telecommunications_September_8_2013.pdf

“Ne kemi shpallur ftesën për shprehje të interesit për frekuenca specifike për operatorin mobil.”

— EKREM HOXHA,
PRESIDENTI I
BORDIT TË ARKEP



“Ne kemi shpallur ftesën për shprehje të interesit për frekuenca specifike për operatorin mobil”

— EKREM HOXHA,
PRESIDENTI I
BORDIT
ARKEP

Më 20 mars 2015, Rregullatori i Postës dhe Telekomit të Kosovës (ARKEP) shpalli një tender publik për këtë kompani. Presidenti i bordit Ekrem Hoxha tha se kompanitë serbe mund të marrin pjesë në proces.

“Ne kemi shpallur ftesën për shprehje të interesit për frekuenca specifike për operatorin mobil”, tha Hoxha për BIG DEAL.

Hoxha tha se që nga 8 prilli, vetëm IPKO dhe VALA kanë aplikuar. Janë 42 ditë në dispozicion pas shpalljes së tenderit për ta shprehur interesimin.

Hoxha megjithatë tha se disa detaje duhet të shtjellohen në një plan, i cili është cekur në marrëveshjen e shtatorit 2013. Megjithatë, Hoxha tha për BIG DEAL se ende nuk ka plan të rënë dakord për zbatimin e marrëveshjes.

Austria ende planifikon të aplikojë për Kosovën për përdorimin e kodit 383 ose 384. Megjithatë, Kosova dëshiron ta rishikojë përmbytjen e draft-tëksit të vendimit të Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU) për kod dhe përmbytjen e letrës së aplikimit për ta bërë atë “politikisht të saktë dhe joparagjykuese⁸⁹”. Një burim në Qeverinë e Kosovës tha për BIG DEAL se drafti aktual i letrës kërkon lejen e Serbisë për të krijuar një kod, ndërsa Kosova konsideron se Serbia veçse e ka dhënë miratimin e saj në marrëveshjen e shtatorit 2013. Një zgjidhje e mundshme mund të jetë që të bëhet referencë në marrëveshjen e 8 shtatorit 2013 në këtë letër.

Megjithatë, një zyrtar serb tha për BIG DEAL se në fakt, Austria nuk ka të drejtë të aplikojë dhe se kërkesa duhet të vijë nga Serbia. Zyrtari tha se tenderi që u hap më 12 mars 2015 duhet të mbyllet për shkak se është i hapur për kompanitë nga çdo vend, kur në realitet një kompani serbe duhet ta fitojë kontratën në mënyrë që të jepet leja për një kod tjetër shtetëror.⁹⁰

Në ndërkohë, Kosova po humb para. Monako, që ka dhënë me qira kodin e saj ndërkombëtar telefonik për dy nga tri kompanitë e telekomit që operojnë në Kosovë, merr 7 milionë euro në vit nga Kosova, sipas Rregullatorit Kosovar të Postës dhe Telekomit (ARKEP)⁹¹. Analisti i ARKEP-it, Ekrem Hoxha thotë se kur Kosova ta ketë kodin e saj, ajo do t'i kursejë mes 5 deri në 6 milionë euro në vit.⁹²

Kjo ka kushtuar gjithsej 48 milionë euro, sipas ish kryeshefit ekzekutiv të Postës dhe Telekomit të Kosovës, Mehdi Latifaj.⁹³

Ndërkohë, konsumatorët e zakonshëm janë duke paguar tarifa astronomike për roaming, madje edhe për udhëtimet në Maqedoni apo Shqipëri, për shkak të kodit të vendit.⁹⁴

“Në BE dhe në vendet fqinje, tarifën për roaming janë të rregulluara”, shpjegon Bardha Ahmeti, e cila hulumtoi kostot e larta të roamingut për Kosovën për OJQ-në “LENS”. “Meqë ne nuk jemi në BE dhe ne nuk kemi kod shtetëror, nuk kemi kontroll mbi tarifën e roamingut. Ne jemi duke paguar mesatarisht tetë

89 Tahiri, 2014, f 16.

90 Intervistë, Mitrovicë e Veriut, prill 2015.

91 6 shkurt 2015 <http://koha.net/?id=278&l=43790>

92 Intervistë, prill 2015.

93 Që nga mesi i marsit 2015, kryeshef aktual është Agron Mustafa.

94 Hulumtimi është kryer nga OJQ LENS.

herë më shumë se fqinjët tanë apo vendet e BE-së për thirrje roaming dhe rreth 100 herë më shumë për internet në roaming”, tha Ahmeti.

Për shumë konsumatorë kosovarë, roamingu në Serbi nuk është fare option, që është problem themelor që pengon biznesmenë, gazetarë, e të tjerë që shkojnë në Serbi për trajtim mjekësor ose për arsye të tjera.

“Cila ishte poenta e nënshkrimit të një marrëveshjeje për telekomin në shtator 2013, kur sot, në prill të vitit 2015, dikush si unë, gazetar, as që mund të përcjell informata për gazetën time nëse e kaloj kufirin me Serbinë, meqë telefonat kosovarë nuk mund ta përdorin roamingun në Serbi?” Tha Lavdim Hamidi, gazetar i së përditshmes Zëri, për BIG DEAL. “Në Evropën e shekullit të njëzetënjë, dy shtete evropiane nuk mund të flasim me njëri-tjetrin me telefona mobilë? Kam menduar që ky dialog do të na ndihmojë që të komunikojmë më mirë, por mendoj se e ka bërë pikërisht të kundërtën.”

Marrëveshja e shtatorit 2013 gjithashtu parasheh që palët të nisin diskutimet rreth shërbimeve postare “në një datë të mëvonshme”. Këto diskutime ende nuk kanë filluar.

Që kur Kosova shpalli pavarësinë nga Serbia, nuk ka pasur ndonjë bashkëpunim formal në mes të sistemeve të tyre postare.

Për shkak të statusit të saj të kontestuar, Kosova përballet me probleme të pranimit të postës dhe pakove nga jashtë. Posta e destinuar për Kosovën shpeshherë shkon në Beograd, i cili i kthen artikujt në vend se t'i përcjellë ata. Kjo e bën të vështirë për njerëzit në Kosovë që të porosisin gjëra nga interneti. Disa kosovarë e shmangin këtë pengesë duke shtuar mbishkrimin “përmes Shqipërisë” në adresën e tyre, e cila drejton postën përmes Tiranës, e cila pastaj e dërgon atë në Kosovë.

Ndërkohë, është gati e pamundur të dërgohet madje edhe një kartolinë në Serbi nga zyrat e rregullta të postës në Kosovë.

Sistemi i postës së Serbisë, Posta Srbije, ende funksionon në Kosovë me 28 zyra postare dhe 240 punonjës. Sipas Rangjel Nojkiqit, shefit të Postës së Serbisë në Kosovë, ekziston një bashkëpunim jozyrtar.⁹⁵

“Ne pranojmë tërë postën që vjen nga Serbia, madje edhe mjetet që adresohen për zyrtarët dhe institucionet në Prishtinë”, tha Nojkiq për BIG DEAL. “Unë sigurohem që punonjësit e mi të dërgojnë postën e rëndësishme për zyrtarët e Kosovës, veçanërisht nëse ka një numër kontakti në pako”, shtoi ai.⁹⁶

“Realiteti është se të dy sistemet postare punojnë këtu krahas për krahas... vetëm se bashkëpunimi duhet të përpunohet”.

Megjithatë, përderisa kjo lehtëson komunikimin për institucionet qeveritare, njerëzit e thjeshtë lihen jashtë.


Energjia

“Nëse do të zbatohet marrëveshja e energjisë, qytetarët e Kosovës do të



“Nëse do të zbatohet marrëveshja e energjisë, qytetarët e Kosovës do të ishin në gjendje të mund të përdornin energjinë e prodhuar nga hidrocentrali i Gazivodës në veri dhe të përdornin linjat e transmisionit të energjisë në Serbi për të siguruar energji për Kosovën – ku të dyja këto do ta bënin energjinë elektrike më të lirë për kosovarët mesatar.”

—DREN DOLI,
GRUPI PËR
STUDIME JURIDIKE
DHE POLITIKE



ishin në gjendje të mund të përdornin energjinë e prodhuar nga hidrocentrali i Gazivodës në veri dhe të përdornin linjat e transmisionit të energjisë në Serbi për të siguruar energji për Kosovën – ku të dyja këto do ta bënin energjinë elektrike më të lirë për kosovarët mesatar.”

—Dren Doli, Grupi për Studime Juridike dhe Politike

Serbia e ka kontrolluar shumicën e kornizës energjetike të Kosovës që nga lufta dhe një pjesë jetike e infrastrukturës mbetet në komunat veriore, ndonëse sistemi është aq i ndërlidhur, sa që nuk mund të funksionojë pa pjesën tjetër.

Liçeni i Gazivodës që gjendet në Zubin Potok, furnizon 60 për qind të ujit të Kosovës për pirje dhe për ftohje të termocentralit në Obiliq 10 kilometra larg Prishtinës që prodhon së paku dy të tretat e energjisë së Kosovës. Kjo do të ketë ndikim negativ jo vetëm në Kosovën por edhe në stabilitetin e rrjetit të energjisë në Serbi, si dhe atyre në Rumani dhe Bullgari.

Palët janë pajtuar që organet e tyre të bartjes së energjisë KOSTT-i nga Kosova dhe EMS-ja nga Serbia, do të nënshkruajnë një marrëveshje dypalëshe, për të vendosur dhe rregulluar marrëdhëniet në mes të dy operatorëve të sistemit të transmisionit. Është pritur që të dy rregullatorët të lëshonin licenca për tregtim (import, eksport, transit) dhe furnizim të kompanive të tyre përkatëse të shpërndarjes. Palët gjithashtu janë pajtuar që të krijojnë një kompani të re sipas ligjeve të Kosovës, e cila do të ofrojë shërbime të shpërndarjes në komunat veriore me shumicë serbe. Kosova dhe Serbia gjithashtu u pajtuan që në një kohë të ardhshme të gjejnë një metodë të përbashkët për zgjidhjen e kërkesë-pasive që të dyja palët kanë ushtruar ndaj tjetrës për përdorimin e linjave të transmisionit, duke rënë dakord që të kërkojnë arbitrim ndërkombëtar nëse nuk gjendet zgjidhja brenda gjashtë muajve.

Operatori i Transmisionit, Sistemit dhe Tregut të Energjisë në Kosovë (KOSTT) mirëmban dhe operon rrjetin e transmisionit në të gjithë vendin, por kompania shtetërore e Serbisë “Elektromreze Srbije” mban kontrollin përfundimtar (ndonëse rralëherë e ushtron këtë fuqi).

Dy operatorët nënshkruan një marrëveshje në shkurt të vitit 2014 për rregullimin e operacioneve dhe marrëdhënieve të tregut, e cila parashikonte që KOSTT-i do të bëhet një hapësirë e pavarur rregullative në kuadër të rrjetit evropian të operatorëve të transmisionit (ENTSOE).

“[Serbia] alokon çdo muaj linjat e interkoneksionit të Kosovës me Maqedoninë, Malin e Zi dhe Shqipërinë,” shpjegon Naim Bejtullahu, drejtor i KOSTT-it.

“Ne shpresojmë se që nga 1 qershori ky alokim do të kryhet nga KOSTT-i, meqë presim që të sinkronizohemi nga ENTSOE.”

Më 14 shtator 2014, KOSTT-i dhe EMS-ja nënshkruan një marrëveshje për menaxhimin e rrjetit dhe sistemit të operacioneve, duke siguruar edhe bazën ligjore për funksionimin e pavarur të sistemit të energjisë elektrike.

“Kosova furnizon tërë territorin e Kosovës me energji elektrike”, tha Bejtullahu për BIG DEAL. “Problemi është se në veri ende nuk është siguruar qasja efektive për faturim dhe inkasim për energjinë e shpenzuar nga konsumatorët. Marrëveshja e nënshkruar me Serbinë dhe Plani i miratuar i Veprimt për Zbatim,

95 Intervistë me Nojkiq në Graçanicë, dhjetor 2014

96 Shih <http://www.balkaninsight.com/en/article/kosovars-go-far-to-send-letters-to-serbia>

në të ardhmen e afërt mund të sigurojnë një mundësi për inkasimin e parave për furnizim me energji elektrike.”

Kosova pohon se procesi i zbatimit është bllokuar për shkak se Serbia dëshiron një kompani të re të themeluar për shpërndarje të energjisë që nuk është nën kompetencat e kompanisë.

Nermine Arapi, drejtoreshë tregtare e KESCO-s, kompanisë private përgjegjëse për shpërndarjen e energjisë elektrike, ka thënë për BIG DEAL se “ende nuk ka përmirësim për sa i përket varësisë së Kosovës nga EMS-ja”.

“KESCO ka kryer import dhe eksport varësisht nga kapaciteti i transmisionit të lejuar nga EMS-ja e Serbisë”, tha ajo. “Në rast të pamundësisë për të siguruar kapacitete ndërkufitare, KESCO-ja është detyruar që të reduktojë prodhimin për të mos shkaktuar devijime në sistemin elektroenergetik.”

Kosova tani dëshiron të arrijë marrëveshje për kompensim për humbjet e shkaktuara nga kontrolli i rrejtë të transmisionit nga EMS-ja. EMS-ja ka alokuar përdorimin e linjave të transmisionit të Kosovës që nga viti 2004. Qeveria e Prishtinës vlerëson se në periudhën nga 2004 deri 2014 ka humbur deri në 150 milionë euro.

Mungesa e zbatimit qon edhe në dëm të konsumatorëve të thjeshtë.

Nëse do të zbatohet marrëveshja e energjisë, qytetarët e Kosovës do të mund të përdornin energjinë e prodhuar nga hidrocentrali i Gazivodës në veri dhe të përdornin linjat e transmisionit të energjisë në Serbi për të siguruar energji për Kosovën – ku të dyja këto do ta bënin energjinë elektrike më të lirë për kosovarët mesatar”, tha për BIG DEAL, Dren Doli nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike.

Konkluzë

Në vizitën e saj të fundit në Beograd, përfaqësuesja e lartë Mogherini deklaroi që është prioritet i BE-së që t'i hapë kapitujt e parë të negociatave për anëtarësim të Serbisë para fundit të vitit 2015. Sipas burimeve që kanë njohuri për procesin e anëtarësimit, janë disa kapituj që mund të hapen tani, por për shkak të rëndësisë që i ka dhënë normalizimit me Kosovën, Bundestagu Gjerman miratoi një rezolutë me të cilën kërkon që kapitulli i parë që do të hapet për Serbinë të jetë Kapitulli 35. Ky kapitull zakonisht është i rezervuar për çështje të ndryshme, por në këtë rast ai ka të bëjë “marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë” ndërmjet Serbisë dhe Kosovës.

Para se të mund të hapet Kapitulli 35, Serbia dhe Kosova duhet ta zbatojnë pjesën më të madhe të marrëveshjes së 19 prillit, sipas diplomatëve në Beograd dhe Prishtinë. Prandaj, duket se objektiv duhet të jetë krijimi i Asociacionit deri në fund të vitit. Gjatë muajve në vazhdim do të diskutohet shumë mbi statutin e Asociacionit/Bashkësisë së Komunave me Shumicë Serbe, por siç u dëshmuua nga thirrjet telefonike të kohëve të fundit të kryeministrave Mustafa dhe Vuçiq, pak vullnet politik mund të hapë shumë rrugë.

Megjithatë, ngjarjet e muajve të parë të vitit 2015 tregojnë se përparimi mund të priset lehtë dhe se qytetarët e Kosovës dhe të Serbisë vazhdojnë të

“KESCO ka kryer import dhe eksport varësisht nga kapaciteti i transmisionit të lejuar nga EMS-ja e Serbisë.”...
“Në rast të pamundësisë për të siguruar kapacitete ndërkufitare, KESCO-ja është detyruar që të reduktojë prodhimin për të mos shkaktuar devijime në sistemin elektroenergetik.”

— NERMINE ARAPI,
DREJTORESHË
TREGTARE E
KESCO-S

“Ne po ia dalim që t'i shmangim krizat e vogla nga dita në ditë, por duhet ta fillojmë punën e vështirë të trajtimit të rrënjëve të problemeve.”

— DIPLOMAT I BE-SË

ndjejnë zemërim të thellë në lidhje me tregimet kontradiktore rreth së kaluarës. Protestat në Prishtinë mund të mos kishin pasur të njëjtin nivel të ashpërsisë sikur ish-ministri Jablanović të mos kishte deklaruar në televizionin publik se ai “nuk kishte njohuri” nëse ushtria serbe ka kryer krime lufte në Kosovë. Përshlytja është krijuar se progresi i qëndrueshëm nuk do të vijë pa diskutime të vështira rreth konfliktit të fundit.

Dy raunde të suksesshme të zgjedhjeve janë mbajtur në veri të Kosovës, por marrëdhëniet midis politikanëve serbë të Kosovës dhe partnerëve të tyre të koalicionit në qeveri janë tensionuar pothuajse që nga krijimi i koalicionit. Marrëveshjet e fundit për integrimin e gjyqësorit dhe trupat e Mbrojtjes Civile duhen lavdëruar, por ato nuk kompensojnë faktin se zbatimi ka qenë i ngadalhtë që nga fillimi i vitit 2014. Zbatimi do të përmirësohet kur komunikimi dhe konsultimi i qëndrueshëm të bëhen normë.

Fundi i vitit 2014 ishte periudhë e tranzicionit për Bashkimin Evropian. Pas periudhës së ndryshimit të personelit, pas së cilës erdhi një Përfaqësuese e Lartë e re dhe një ekip i ri i saj, disa prej të cilëve janë ende të panjohur në kohën e këtij publikimi, BE-ja duhet të dërgojë një mesazh për të dyja palët se ajo do të vazhdojë të jetë e angazhuar fort, veçanërisht në negociatat mbi Asociacionin/ Bashkësinë e Komunave me Shumicë Serbe.

Themelimi i saj i suksesshëm do të hapë derën që Serbia të tërheqë me kujdes institucionet e saj qeverisëse nga territori i Kosovës, duke siguruar qasje në arsim dhe kujdes shëndetësor për serbët e Kosovës. Ky tranzicion duhet të bëhet me kujdes ashtu që sa më pak njerëz të preken nga humbja e mjeteve të jefesës dhe pagat e tyre. Në këtë proces duhet të thirret shoqëria civile dhe aktorë të tjerë lokalë për të hartuar një plan kohor për shpërbërjen përfundimtare të institucioneve serbe dhe krijimin e një bordi mbikëqyrës të qytetarëve për ta monitoruar dhe udhëzuar atë.

Serbia, Kosova dhe BE-ja duhet të jenë të kujdesshme në mënyrë që marrëveshjet aktuale, si dhe marrëveshjet e mundshme në të ardhmen, të mos mbështeten në sisteme të kuotave etnike, të cilat janë në kundërshtim me standardet evropiane dhe do të mund të kundërshtoheshin para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nëse dhe kur Kosova të anëtarësohet në Këshillin e Evropës.

Serbia gjithashtu duhet të bëjë ndryshime të nevojshme në Kushtetutën e saj për të mos rrezikuar progresin e arritur gjatë procesit të dialogut.

Nëse zbatimi vazhdon sikurse vitin e kaluar, atëherë të dyja palët do ta presin normalen për një kohë të gjatë.

Për më tepër, janë një numër çështjesh që ende nuk janë trajtuar. Për shembull, Serbia ende nuk ka shpërbërë administratën e saj tatimore në Kosovë. Çështja se ku dhe si personat që marrin pensione serbe do të vazhdojnë ta bëjnë këtë në mënyrë të qëndrueshme duhet po ashtu të diskutohet. Gjithashtu, kjo vlen edhe për çështjen e kujdesit shëndetësor.

Privatizimi vazhdon të jetë çështje problematike dhe gjersa Brukseli pre-

tendon se privatizimet nuk janë të lidhura me procesin e normalizimit⁹⁷, të dy proceset do të vazhdojnë paralelisht dhe do të kenë ndikim të madh te njëri-tjetri. Brukseli duhet të jetë i gatshëm që të jetë më i angazhuar.

Siç theksoi një diplomat i BE-së për BIG DEAL, “Ne po ia dalim që t’i shmangim krizat e vogla nga dita në ditë, por duhet ta fillojmë punën e vështirë të trajtimit të rrënjëve të problemeve.”

⁹⁷ Diplomati i BE-së në Prishtinë, prill 2015.

Published by:



